



RAPORT
I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

**FABRIKA DRENA PËR PËRPUNIMIN E QUMËSHTIT,
PRODUKTEVE DHE NËNPRODUKTEVE TË TIJ
NGA “DRENA sh.p.k.”, NË SKËNDERAJ**

Prill, 2025



RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

FABRIKA DRENA PËR PËRPUNIMIN E QUMËSHTIT, PRODUKTEVE DHE NËNPRODUKTEVE TË TIJ “DRENA sh.p.k.”, NË SKËNDERAJ

Subjekti/Investitori:

“DRENA sh.p.k.”

Hartues i VNM-së:

Agron VELIU - ekspert i mjedisit
(person fizik i licencuar – nr. lic. 29/19/24)

Prill, 2025

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	5
2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së.....	6
2.1 Rregullativa ligjore	6
2.2. Metodologjia e punës.....	7
3. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT DHE MJEDISIT	9
3.1. Potencialet ekzistuese	9
3.2. Pozita gjeografike e lokacionit.....	10
3.3. Përshkrimi i vendndodhjes së projektit dhe gjendja ekzistuese.....	11
3.4. Përshkrimi teknik i projektit/procesit – Qumështorja DRENA	15
3.4.1 Historiku i kompanisë DRENA.....	15
3.4.2 Misioni i kompanisë Drena.....	16
3.4.3 Struktura organizative e Drenës	17
3.4.4 Teknologjia dhe pajisjet e prodhimit në qumështoren Drena.....	18
3.4.5 Cilësi, teknologji dhe traditë në çdo pikë qumështi.....	21
3.4.6 Produktet e kompanisë Drena.....	21
3.4.7 Laboratori	27
3.4.8 Çmimet	28
3.4.9 Promocioni.....	28
3.4.10 Distribuími.....	29
3.4.11 SWOT analiza e qumështores Drena.....	29
3.5. Përshkrimi i alternativave të mundshme të projektit	30
4. PËRSHKRIMI I ASPEKTEVE MJEDISORE EKZISTUESE.....	32
4.1. Popullata - vendbanimi dhe infrastruktura.....	32
4.2. Klima.....	32
4.3. Karakteristikat hidrografike	33
4.4. Karakteristikat pedologjike dhe shfrytëzimi i tokës	34
4.5. Karakteristikat sizmike të komunës së Skënderajt.....	34
4.6. Ndotja dhe degradimi i mjedisit (ajri, uji, toka).....	35
4.7. Ujërat.....	37
4.8. Biodiversiteti dhe trashëgimia kulturore.....	38
5. PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS	40
5.1. Ndikimet në ajër.....	41
5.2. Ndikimet në tokë.....	42
5.3. Ndikimet në ujë.....	42

5.4. Ndikimi në peizazh	43
5.5. Ndikimi në florë dhe faunë	43
5.6. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë	44
5.7. Ndikimet nga zhurma.....	44
5.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore.....	45
6. MASAT PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE NË MJEDIS	46
6.1. Masat për mbrojtjen e ajrit	46
6.2. Masat për mbrojtjen e tokës.....	47
6.3. Masat për mbrojtjen e ujit	48
6.4. Masat për mbrojtjen e florës dhe faunës	50
6.5. Masat për mbrojtjen nga zhurma	51
6.6. Masat për mbrojtjen nga rreziqet aksidentale	51
6.7. Masat rehabilituese pas përfundimit të projektit.....	52
7. PROGRAMI I MONITORIMIT	53
8. PËRFUNDIME	53
9. PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE.....	55
Kosto investive e projektit	59
Lista e bibliografisë të burimeve të përdorura:	59
Shtojcat:	59

1. HYRJE

Për hartimin e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis për ‘Qumështoren Drena’, në Skenderaj, nga kompania “DRENA Sh.P.K.”, me nr. unik identifikues 811014381, nevojitet të bëhet analizë e ndikimeve të mundshme në mjedis për ‘Fabrikën Drena për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të qumështit’.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për marrjen e pëlqimit mjedisor, si dokument i nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë së kompanisë.

Andaj, përmes këtij raporti të VNM-së do të përkufizohen të gjitha ndikimet relevante që mund të paraqiten në relacionin bazë të procesit të përpunimit të qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij dhe mjedisit jetësor duke marrë parasysh mjedisin e gjerë.

Hartimi i raportit për VNM bëhet me qëllim që në mënyrë transparente të paraqitet ndikimi në mjedis për projektin e përpunimit të qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij nga kompania “DRENA sh.p.k.”, në Klinë të Poshtme, komuna e Skënderajt, me objektet përcjellëse dhe me të gjitha veprimtaritë punuese në mënyrë që të mundësohet ruajtja e mjedisit.

Ky vlerësim i ndikimit në mjedis për fabrikën për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij nga “DRENA sh.p.k.”, është punuar duke u bazuar në projektin e ndërtimit, gjendjen reale në terren, karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese të mjedisit rreth lokacionit ku është fabrika për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij, si dhe dokumentacionit teknik ekzistues.

Detyra e përgatitjes së këtij raporti të VNM-së, kryesisht ka për qëllim identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis si dhe propozimin e veprimeve për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis gjerë në kufijtë e lejuar. Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet për mbrojtjen e mjedisit që dalin nga ky raport i VNM-së, duhet të merren për bazë, gjatë fazës së aktiviteteve të punës së fabrikës për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij dhe pas përfundimit të aktivitetit të punës së impiantit të tillë nga kompania “DRENA sh.p.k.”.

2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së

Në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) është miratuar Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181 (i botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 2; 6 Janar 2023), i cili përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të raportit të VNM-së.

Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis - Nr. 08/L-181, ka për qëllim që:

- ✓ të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit përmes parandalimit të dëmeve dhe efekteve negative në mjedis të projekteve publike apo private;
- ✓ të përcaktoj rregullat dhe procedurat për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të projekteve në mjedis, për të siguruar parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative të projekteve të propozuara publike dhe private;
- ✓ garantimin e një procesi gjithëpërfshirës dhe të hapur vendimmarrjeje përmes përcaktimit të rregullave dhe procedurave administrative, gjatë procesit të vendimmarrjes për pajisje me pëlqim mjedisor.

Analiza përfshin identifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti në mjedis gjatë funksionimit normal të vazhdueshëm të impiantit për përpunimin dhe riciklimin e materialeve zjarrrduruese të përdorura, dhe atë:

- ✓ identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin
- ✓ vlerësimin e ndikimit në mjedis
- ✓ propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin e ndikimeve negative mjedisore gjerë në kufijtë e lejuar.

2.1 Rregullativa ligjore

a) Dokumentacioni normativ

Me rastin e hartimit të raportit të VNM-së, për impiantin për përpunimin dhe riciklimin e materialeve zjarrrduruese të përdorura nga “Drena sh.p.k.”, janë marrë për bazë ligjet më të rëndësishme të zbatuara që janë përmendur në vijim:

- Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181
- Ligji për mbrojtjen e mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08/L-025
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110

- Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për kimikate Nr. 04/L-197
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-197 për kimikate Nr. 08/L-116
- Ligji për mbeturina Nr. 04/L-060
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina Nr. 08/L-071
- Ligji për mbrojtjen nga zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 08/L-261
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor.

b) Dokumentacioni teknik

- ✓ Projektit të ndërtimit të fabrikës për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij nga “Drena sh.p.k.” në Klinë të Poshtme të Skenderajt, me objektet përcjellëse punuese i bashkëngjitet dokumentacioni teknik i cili edhe është marrë në shqyrtim, si:
- ✓ Certifikata e regjistrimit të biznesit
- ✓ Kopja e planit të parcelave/ngastrave, gjendjen e situacionit.
- ✓ Certifikata mbi të drejtat e pronës.
- ✓ Projekti bazë për fabrikën për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij.

2.2. Metodologjia e punës

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis për fabrikën për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij, me objektet përcjellëse, bëhet në disa faza:

a) Informatat themelore që nënkupton identifikimet, siç janë:

- ✓ burimet themelore të ndikimeve në mjedis.
- ✓ popullata ekzistuese me karakteristikat demografike.
- ✓ karakteristikat e dheut, topografia dhe peizazhi në lokacionin ku është paraparë të ndërtohet projekti i paraparë.
- ✓ klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike,
- ✓ cilësia e ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë,

- ✓ bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar.

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve

- ✓ madhësia dhe lloji i ndotjes,
- ✓ karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës,
- ✓ gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar,
- ✓ vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse.

c) Analiza e rrezikimit të:

- ✓ njeriut,
- ✓ vlerave materiale,
- ✓ vlerave natyrore

d) Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionin ku ndodhet fabrika për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij nga “Drena sh.p.k.” në Klinë të Poshtme, komuna e Skenderajt.

Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti të VNM-së, i kushtohet konstatimit dhe vlerësimit të gjendjes ekzistuese. Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që nuk ka të bëjë me ndonjë potencial të shprehur ekologjik.

Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjen aktuale të mjedisit në këtë lokacion.

3. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT DHE MJEDISIT

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë themelore për hartimin e raportit të VNM-së. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë terren ku shtrihet projekti.

Për t'u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për të u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike.

3.1. Potencialet ekzistuese

Njëri nga elementet kyç të hulumtimi i gjendjes ekzistuese të mjedisit është hulumtimi i potencialit ekzistues, e që konsiston në analizën e mirëfilltë të tërësisë hapësinore në zonën më të gjerë të fabrikës për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij në Klinë të Poshtme të Skenderajt nga “Drena sh.p.k”, me qëllim që në bazë të pasojave të njohura të vlerësohen mundësitë e rrezikut ekologjik dhe në bazë të tyre të rekomandohen masat për zvogëlimin ose edhe eliminimin e tyre.

Karakteristikat e potencialit ekologjik përbëhen nga kombinimi i ndikimeve të ndërsjella të faktorëve natyrorë siç janë: toka, uji, ajri, relievi, flora dhe fauna.

Çdonjëra nga potencialet ekologjike në këtë mënyrë posedon funksione të caktuara, që në esencë kanë rëndësi të dorës së parë në analizën e problematikës së tërësishme të mbrojtjes së mjedisit.

Ndikimi i ndërsjellë i faktorëve të veçantë si dhe ndikimi i tyre në formimin e potencialit ekologjik dhe i funksioneve të tyre themelore me interes për analizën në fjalë, së bashku me kompleksin e marrëdhënieve të mundshme është paraqitur në figurën 1.

Në bazë të raporteve të paraqitura në figurën 1, është e qartë që faktorët natyrorë formojnë disa potenciale natyrore karakteristikat funksionale të të cilave duhen marrë parasysh gjatë valorizimit të ndikimit në mjedis të fabrikës për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij, të ndërtuar në hapësirën e lartcekur.




Figura 1: Raportet themelore ndërmjet faktorëve natyrorë dhe potencialeve ekologjike

3.2. Pozita gjeografike e lokacionit

Lokacioni ku do të shtrihet projekti bën pjesë në zonën kadastrale të Klinës së Poshtme, që është pjesë e territorit të komunës së Skënderajt, dhe i takon regjionit të Mitrovicës.

Komuna e Skënderajt zë vend qendror në Drenicë, shtrihet në një sipërfaqe prej 378 km². Në veri kufizohet me Komunën e Mitrovicës, në lindje me Vushtrinë, në jugperëndim me Drenasin (Gllogocin) dhe Klinën, ndërsa në perëndim me Burimin (Istogun). Nëpër Komunë kalojnë rrugë të rëndësishme automobilistike të cilat e lidhin me qendrat e tjera të Kosovës.

Territori i Komunës së Skenderajt ka konfiguracion kodrinoro-malorë me lartësi mbidetare mesatare prej 500-700m, kurse pikën më të lartë e paraqet maja e Qyçavicës me lartësi 1117 m. Ka reliev të butë, përshkohet me lugina lumenjsh të vegjël, kryesisht dominon klimë e mesme kontinentale që karakterizohet me dimra të ashpër, vera të thata me temperatura të larta e reshje të pakta, ndërsa ka një florë dhe faunë të pasur.

Komuna e Skënderajt si pozicion gjeografik gjendet në qendër të Kosovës, 50 km në veriperëndim të kryeqytetit të Kosovës Prishtinës. Skënderaj si komunë është i përshirë në regjionin e Mitrovicës dhe është 20 km në juglindje të këtij qyteti.

Komuna e Skenderajt është në qendër të Kosovës dhe kufizohet me këto komuna të Kosovës:

- Në Veri me Mitrovicën
- Në Veriperëndim me Burimin (Istogun)
- Në Perëndim me Klinën
- Në Juglindje me Drenasin
- Dhe në Verilindje me Vushtrinë

Nëpër komunë kalojnë disa rrugë me karakter të rrugëve nacionale si:

- Në pjesën veriore rruga Pejë-Mitrovicë, e cila ka akse Lindje – Perëndim.
- Rruga Skënderaj-Drenas-Komoran-Prishtinë, ka aks Veri-Jug dhe është rrugë me karakter nacional.
- Me karakter të rrugës regjionale është rruga Skënderaj – Klinë.
- Gjithashtu, Skënderaj është i lidhur edhe me një rrugë të asfaltuar me qytetin e Vushtrrisë.



Figura 2: Pozita gjeografike e komunës së Skënderajit në Kosovë

3.3. Përshkrimi i vendndodhjes së projektit dhe gjendja ekzistuese

Projekti fabrika për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij nga “Drena shpk”, shtrihet në zonën kadastrale Klinë e Poshtme të komunës së Skenderaj, gjegjësisht në anën e djathtë të rrugës Skënderaj-Klinë e Poshtme-Klinë e Epërme-Mitrovicë, përkatësisht në ngastrën kadastrale nr. P-72015025-01111-0, me sipërfaqe të parcelës 8557 m², zona kadastrale Klinë e Poshtme, në vendin e quajtur ‘ALINOÇA-BASHTA’ sipas Kopjes së Planit lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale Skënderaj (954/11878/2025; 01.04.2025) bashkangjitur këtij raporti të VNM-së. Lloji i shfrytëzimit i parcelës me nr. P-72015025-01111-0 është Bujqësore (Arë e klasës 1) me 3239 m² dhe Tokë ndërtimore (oborr) me 5318 m², ndërsa sipas HZK-së (fig. 3) bën pjesë në ZI-L (zonë industriale e lehtë). Lloji i pronave është shoqërore (urbane) të cilat kompania ‘DRENA shpk’ i ka marrë me qirambajtje për 99 vite (sipas Certifikatës nr. 11677/25; 28.03.2025).




Figura 3: Harta zonale e komunës së Skënderajt

Sipas Hartës Zonale të Komunës (HZK) në këtë zonë (ZI-L – zonë industriale e lehtë) mund të akomodohen industritë e lehta me aktivitetet e tyre. Të gjitha përdorimet e kryera në këtë zonë duhet të jenë të mbyllura brenda një strukture, përveç nëse lejohet specifikisht të veprojnë jashtë dyerve. Veprimtaritë e lejuara në ZI-L:

- Industritë e produkteve të lehta
- Ndërmarrje për prodhim industrial të cilat nuk shkaktojnë erëra apo zhurmë, ndotje të ajrit dhe të cilat nuk paraqesin rrezik nga eksplozimi apo rrezatimi në rrethinë
- Ndërmarrje për deponim dhe distribuim të cilat nuk shkaktojnë dëme të tepërta për rrethinën dhe ambientin dhe ndërmarrje të cilat nuk paraqesin rrezik nga eksplozimi apo rrezatimi në rrethinë,
- Industri e prodhimeve të lehta,
- Prodhim i pijeve, ushqimeve dhe produkteve të duhanit.

Shfrytëzime dytësore

- Shërbime logjistike: kaldaja, depo dhe trafot e rrymës,
- Shfrytëzime të veçanta,
- Shërbime tregtare: zyre administrative, shërbime hotelerie, salla për ekspozim, hapësira për inkubator, qendra për konferencë, pompa të derivateve.

Distanca e lokacionit ku shtrihet fabrika për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij të qumështores Drena deri në qendër të fshatit Klinë e Poshtme është afërsisht 600 m, ndërsa distanca deri në qendrën e qytetit të Skënderajt është rreth 850 m).

Lokacioni ku shtrihet fabrika dhe qumështorja Drena ka kyçe të drejtpërdrejt në rrugën kryesore Skënderaj – Klinë e Poshtme, dhe qasja në rrugë është e lehtë dhe e përshtatshme për hyrje-dalje. Po ashtu, përreth fabrikës dhe objektit të qumështores ka objekte tjera afariste dhe prodhuese. Në anën e majtë ndodhet një mulli elektrik (kompani private), në pjesën e poshtme

dhe përreth parcelës kalon dega e lumit Klina e cila pastaj shkarkohet në lumin kryesor. Në një distancë më të largët gjithashtu ka objekte tjera afariste prodhuese dhe shtëpi banimi, edhe pse ky projekt nuk i atakon drejtpërdrejt shtëpitë e banimit pasi që aktiviteti zhvillohet kryesisht brenda objekteve, dhe komponenta më e atakuar është uji sipërfaqësor dhe nëntokësor. Në përgjithësi, vendi i projektit është rregulluar dhe projektuar nga investitori për një funksionalizim sa më të përshtatshëm dhe me infrastrukturë të nevojshme (ujë, rrymë, rrugë, etj.).

Situacioni i terrenit ku shtrihet projekti i qumështores Drena sh.p.k. është dhënë si shtojcë e këtij raporti të VNM-së.

Kompania DRENA sh.p.k i ka edhe dy (2) dokumente/vendime për ‘Lejet mjedisore komunale-LMK’ të lëshuara nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Ambinetit (DUMA) e komunës së Skënderajt, për ndërtimin dhe ushtrimin e veprimtarisë, si në vijim:

- Vendimi mbi LMK për ndërtimin e objektit për zgjerimin e kapaciteteve prodhuese të qumështores (depo) me etazhitet P+2 në parcelën kadastrale me nr. P-72015025-01111-0 (vendimi i datës 17.10.2023), dhe
- Vendimi mbi LMK për ndërtimin e katit shtesë S+P+2 në objektin ekzistues afarist S+P+1E në të njëjtën parcelë (vendimi i datës 27.09.2024).

Të dy këto vendime për LMK të lëshuara nga DUMA e komunës së Skënderajt i janë bashkangjitur këtij raporti të VNM-së si shtojca.

Pamja e lokacioni ku ndodhet projekti i fabrikës për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij është paraqitur në figurat 4, 5 dhe 6, dhe shtrihet në parcelat e përmendura më lart.



Figura 4: Lokacioni i projektit të fabrikës Drena për përpunimin e qumështit në raport me rrethinën



Figura 5: Lokacioni i projektit të fabrikës Drena në raport me rrethinën (2)



Figura 6: Lokacioni fizik i projektit në parcelën me nr. 001111-0 (burimi: <http://geoportal.rks-gov.net/>)

3.4. Përshkrimi teknik i projektit/procesit – Qumështorja DRENA

3.4.1 Historiku i kompanisë DRENA

Drena SHPK është një kompani prodhuese e specializuar në përpunimin dhe distribuimin e qumështit dhe nënprodukteve të tij, me fokus të veçantë në cilësinë dhe natyralitetin e produkteve. Që nga themelimi i saj në vitin 2015, Drena ka qenë e përkushtuar ndaj ofrimit të produkteve 100% të freskëta dhe natyrale, përfshirë: jogurtin, ajranin, kumshtin, kosin, gjizën, mazën, tëlyenin, si dhe një gamë të gjerë djathërash të prodhuar nga qumështi i lopës, dhisë, deles dhe buallicës.

Drena është gjithashtu prodhuesi i vetëm në Ballkan i Mozzarellaës së buallicës, një produkt unik që e veçon atë në tregun rajonal. Fabrika e kompanisë është e vendosur në Skenderaj, ndërsa pika kryesore e shpërndarjes ndodhet në Fushë Kosovë. Kompania siguron lëndën e parë përmes grumbullimit të qumështit nga fermerët lokalë, me të cilët ka ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme dhe të besueshme. Këto marrëdhënie përbëjnë bazën e sigurimit të një cilësie konstante dhe të lartë në produktet finale.

Në aspektin historik, është me rëndësi të theksohet se përpunimi i qumështit është një traditë e lashtë, e cila ka njohur zhvillime të rëndësishme gjatë historisë. Në shekullin e 14-të, qumështi i lopës filloi të zëvendësojë atë të deles si më i popullarizuar në konsum. Një moment kyç në

sigurinë dhe ruajtjen e qumështit erdhi në vitin 1862, kur mikrobiologu francez Louis Pasteur zhvilloi procesin e pasterizimit, duke hapur rrugë për ruajtjen dhe shpërndarjen e qumështit përtej zonave prodhuese.

Drena është pjesë e kësaj trashëgimie të pasur, duke u dalluar me përkushtimin e saj të vazhdueshëm ndaj cilësisë, inovacionit dhe shërbimit ndaj komunitetit. Me ndihmën e një ekipi të përkushtuar dhe të trajnuar profesionalisht, kompania ka fituar besimin e konsumatorëve në mbarë Kosovën.

Një nga arritjet më të rëndësishme të kompanisë është Çmimi Ndërkombëtar për Cilësi në Ushqim dhe Pije, i ndarë në nëntor të vitit 2017 nga Komiteti Zgjedhor i International Food & Beverage Quality Award. Kjo njohje u bazua në vlerësimet e 7500 ndërmarrësve anëtarë të Klubit Global Trade Leaders, që përfaqësojnë 90 vende të ndryshme. Qëllimi i këtij çmimi është të promovojë filozofinë e cilësisë dhe ekselencës në industrinë e ushqimit dhe të pijes, duke vlerësuar kompanitë që dallohen për standarde të larta prodhimi dhe distribuimi.

Përmes përkushtimit ndaj cilësisë dhe autenticitetit, Drena jo vetëm që kontribuon në ekonominë lokale, por edhe ushqen çdo ditë familjet kosovare me produkte të sigurt dhe të shijshme, duke promovuar shëndetin dhe lumturinë në komunitet.

3.4.2 Misioni i kompanisë Drena

Misioni ynë është të frymëzojmë një shoqëri të shëndoshë duke i lidhur njerëzit me ushqim të vërtetë, të prodhuar me përkushtim, ndershmëri dhe kujdes të vazhdueshëm. Ne synojmë që përmes ofrimit të produkteve të freskëta, të shëndetshme dhe të prodhuara në mënyrën më miqësore, të rrisim jo vetëm kënaqësinë e konsumatorëve tanë, por edhe besimin e tyre të përhershëm në markën Drena.

Burimi kryesor i lëndës së parë është qumështi i grumbulluar nga fermerët vendorë, të cilët kultivojnë kafshët në kushte natyrore dhe të favorshme për mirëqenien e tyre. Kjo qasje humane dhe ekologjike kontribuon drejtpërdrejt në cilësinë e lartë të produkteve tona, të cilat tashmë janë vlerësuar edhe në nivel ndërkombëtar. Kujdesi për kafshët, respekti ndaj natyrës dhe praktikat e qëndrueshme janë elementë thelbësorë të filozofisë sonë prodhuese.

Produktet tona mbajnë emra origjinalë që reflektojnë autenticitetin dhe lehtësojnë identifikimin nga konsumatori. Ne hulumtojmë vazhdimisht për të sjellë receta të reja, duke ndjekur trendet bashkëkohore të tregut dhe preferencat e konsumatorëve. Çdo investim apo inovacion i yni

është i orientuar drejt përmbushjes së nevojave dhe shijeve të konsumatorit – i cili mbetet gjithmonë në qendër të veprimtarisë sonë.

Drena e konsideron konsumatorin si pjesë të pandashme të familjes së saj. Ai është partneri ynë më i respektuar, pa të cilin ekzistenca e kompanisë nuk do të kishte kuptim. Prandaj, ne angazhohemi të jemi të sinqertë, të përgjegjshëm dhe gjithmonë në shërbim të tij me produkte të sigurta, cilësore dhe të besueshme.

Në përputhje me vlerat tona etike dhe sociale, Drena promovon dhe zbaton barazinë gjinore në të gjitha nivelet e organizatës. Ne besojmë se një ambient pune gjithëpërfshirës, ku të gjitha gratë dhe burrat kanë mundësi të barabarta për zhvillim profesional dhe pjesëmarrje në vendimmarrje, është kyç për suksesin afatgjatë dhe për ndërtimin e një kulture organizative të shëndetshme dhe progresive.

3.4.3 Struktura organizative e Drenës

Struktura organizative e kompanisë Drena është ndërtuar mbi parimin e ndarjes funksionale, duke e bërë më të lehtë koordinimin dhe specializimin në secilën fushë kyçe të operimit.




Figura 7: Struktura organizative e Drenës

3.4.4 Teknologjia dhe pajisjet e prodhimit në qumështoren Drena

Qumështorja Drena është e pajisur me teknologjinë më moderne, dhe duke qenë e pajisur me makineri moderne, i respekton në përpikëri edhe standardet e rregullativës ushqimore HACCP dhe ISO. Në vijim janë paraqitur lista e pajisjeve dhe pajisjet/teknologjia e prodhimit.

Tabela 1: Pajisjet që përdoren për proces

Pajisja	Sasia (copë)	Kapaciteti	Përdorimi
Tank pranimi	7	130,000 L	Stokimi qumështit të papërpunuar
Pasterizator	1	10,000 L/h	Trajtim termik i qumështit dhe nënprodukteve
Pasterizator	1	5,000 L/h	Trajtim termik i qumështit dhe nënprodukteve
Tank Fermentues	20	85,000 L	Fermentimi i produkteve të freskëta
Tank kremi	3	22,000 L	Fermentimi i produkteve me yndyrë të lartë
Tank ruajtëse	6	60,000L	Vendosja e qumështit të pasterizuar
Tank Steril	1	12,000 L	Ruajtja e qumështit të sterilizuar
Linjë qumështi UHT	2	12,000 L/h	Paketimi i qumështit UHT
Linja PET	1	8,000 L/h	Paketimi i produkte të fermentuara në shishe
Linja prodhimi të ndryshme	7	21,000L	Paketimi i produkteve të ndryshme, e të freskëta
Dhoma frigoriferike	5	450 m ²	Ruajtja e produkteve të freskëta në temperaturë 4-6 °C
Dhoma inkubimi	4	200 m ²	Fermentimi i produkteve në temperaturë 40-44 °C
Sistemi CIP	3	/	Pastrimi i pajisjeve dhe linjave të prodhimit përfshirë dhe kamionët e grumbullimit të qumështit/Laktofriz
Laktofriz	4	10,000 L	Ruajtja e temperaturës së qumështit të freskët dhe të përpunuar
Sistemi i përzierjes së frutave me jogurt	1	2,000 L/h	Përzierja dhe përgatitja paraprake e jogurtit

Më poshtë janë të paraqitura disa nga pajisjet e prodhimit:



Figura 8: Linja TBA 8



Figura 9: Tanku aseptik dhe sterilizatori



Figura 10: Pasterizator



Figura 11: Tanku (Ruajtës)



Figura 12: Linja PET

3.4.5 Cilësi, teknologji dhe traditë në çdo pikë qumështi

Në Qumështoren Drena respektohet çdo hallkë e zinxhirit prodhues. Qumështi përpunohet më pas në një ambient tërësisht të kontrolluar, me makineritë më moderne në rajon, për të prodhuar ushqime të sigurt, të freskëta dhe 100% natyrale.

Qumështorja është e certifikuar me standardet ndërkombëtare të sigurisë ushqimore HACCP, ISO dhe Halal, duke garantuar gjurmueshmëri dhe siguri të plotë në çdo fazë të prodhimit. Prodhimi i produkteve në qumështoren Drena është i ndarë në sektore të ndryshme që përfshijnë:

Sektorët e Prodhimit në qumështoren Drena përfshijnë sektorin e përpunimit të qumështit UHT – i pajisur me pasterizatorë dhe homogjenizatorë modernë, me një kapacitet prodhimi prej 6,000 litra në orë.

Spektori i mbushjes në shishe – linjë automatike me kapacitet deri në 8,000 litra në orë, që garanton sterilitet dhe ruajtje optimale të freskësisë.

Spektori i kremit dhe ajkës me specë – teknologji moderne për ndarje dhe përpunim të yndyrës së qumështit, duke ruajtur shijen autentike tradicionale.

Spektori i kosit – përpunim i fermentuar me kultura bakteriale të kontrolluara, që siguron një kos me strukturë ideale dhe të pasur në vlera ushqyese.

Spektori i djathit – përfshin linja të posaçme për prodhimin e djathërave të freskët, ku përfshihen edhe metoda tradicionale të përpunimit.

Spektori i produkteve të freskëta – përgatitje e produkteve të ndryshme të bazuara në qumësht, të gatshme për konsum të menjëhershëm.

Me një infrastrukturë teknologjike bashkëkohore dhe një ekip të përkushtuar, qumështorja Drena vazhdon të jetë sinonim i cilësisë, traditës dhe inovacionit në industrinë ushqimore të vendit.

3.4.6 Produktet e kompanisë Drena

Kompania Drena ofron një gamë të gjerë të produkteve të qumështit dhe nënprodukteve të tij, të cilat prodhohen ekskluzivisht nga qumështi i grumbulluar nga fermerë vendorë. Të gjitha produktet tona janë 100% natyrale, pa shtesa artificiale, dhe të pasura me yndyrë të pastër shtazore, duke reflektuar përkushtimin tonë për cilësi dhe siguri ushqimore.

Karakteristikat e Produkteve

Origjina vendore	Të gjitha lëndët e para sigurohen nga fermerët lokalë në Kosovë.
Standard natyral dhe bio	Ushqimi i kafshëve dhe procesi i përpunimit janë të bazuara në standarde bio dhe ekologjike.
Mirëqenia e kafshëve	Kompania zbaton praktika që sigurojnë trajtim të denjë për kafshët, duke kontribuar në cilësi të lartë të produkteve përfundimtare.

Dhe produkte të veçanta disa prej të cilave janë të listuara më poshtë.

Qumësht UHT Drena 3.5% yndyrë

Procesi teknologjik i qumështit UHT (Ultra High Temperature) është një proces që trajton qumështin, duke ruajtur cilësinë dhe freskinë për një periudhë të gjatë. Ky proces përfshin disa hapa të rëndësishëm:

Pasterizimi i parë: Qumështi fillimisht pasterizohet në 75°C dhe standardizohet sipas kërkesës, për të siguruar përmbajtjen e duhur të yndyrës dhe komponimeve të tjera.

Sterilizimi dhe homogjenizimi: Qumështi pastaj kalon në procesin e sterilizimit në temperatura shumë të larta, 142°C për 3 sekonda, i cili eliminon bakteret dhe ruan vlerat ushqyese. Pas sterilizimit, qumështi homogjenizohet për të siguruar një strukturë të njëtrajtshme dhe të qëndrueshme.

Trajtimi termik: Ky trajtim termik i shpejtë dhe në temperatura shumë të larta lejon që qumështi të ruajë cilësinë e tij dhe të ketë një jetëgjatësi të gjatë, deri në 6 muaj.

Mbushja dhe stokimi: Qumështi UHT mbushet dhe ruhet për 7 ditë në kushte të kontrolluara për të siguruar stabilitetin dhe cilësinë e tij.

Rikontrolli dhe hedhja në treg: Pas periudhës së stokimit dhe pas kontrollit të parametrave të kërkuar për cilësinë e produktit, qumështi UHT është gati për lansim në treg. Skema teknologjike në vijim tregon hapat e prodhimit të qumështit UHT.




Figura 13: Skema teknologjike e prodhimit të qumështit UHT

Kosi

Procesi i prodhimit të kosit kërkon një kujdes të veçantë teknologjike, duke siguruar cilësi dhe siguri për konsumatorët. Ky proces përfshin disa etapa kryesore:

Trajtimi termik: Fillimisht, qumështi trajtohet me temperaturë prej 75°C për të eliminuar bakteret dhe për të mundësuar standardizimin e tij sipas kërkesës.

Pasterizimi dhe homogjenizimi: Qumështi pastrohet në temperatura të larta (90-92°C), duke u homogjenizuar për të siguruar një strukturë të njëtrajtshme.

Përgatitja për fermentim: Pas homogjenizimit, qumështi vihet në tankun fermentues dhe temperatura e tij ulet në 42°C, që krijon kushte ideale për zhvillimin e kulturave termofile.

Fermentimi: Pas vendosjes në temperaturën e duhur, fillon procesi i fermentimit të kosit. Kjo përfshin qëndrimin e përzierjes për rreth 30 minuta, pas të cilës produkti mbushet në enët përkatëse, duke ruajtur temperaturën 42°C.

Inkubimi: Pasi është mbushur, produkti shkon në inkubim për 4-5 orë në 42°C. Pas kontrollit të parametrave dhe arritjes së pH të dëshiruar, produkti kalon në fazën e ftohjes.

Ftohja dhe ruajtja: Kos i nxehtë ftohet për 48 orë, dhe pas rikontrollit të parametrave të cilësisë, produkti është gati për lansimin në treg. Skema në vijim paraqet etapat e prodhimit të kosit.




Figura 14: Skema teknologjike e prodhimit të kosit



Figura 15: Qumësht Drena 3.5%



Figura 16: Kos Drena 3.2%

Djathi

Prodhimi i djathit të bardhë përfshin disa etapa të rëndësishme, duke filluar nga trajtimi termik i qumështit deri në finalizimin dhe hedhjen e produktit në treg. Ja si zhvillohet ky proces:

Trajtimi termik i qumështit: Qumështi trajtohet termikisht në temperatura 82-85°C për të eliminuar mikroorganizmat dhe për të ruajtur cilësinë e produktit.

Standardizimi dhe parametra të kërkuar: Pas trajtimit termik, qumështi standardizohet dhe parametrat e tij përcaktohen sipas kërkesës për të siguruar cilësinë e djathit të ardhshëm.

Fermentimi dhe shtimi i enzimave: Pasi qumështi ka arritur temperaturën dhe parametrat e duhur, bëhet fermentimi i tij dhe shtimi i enzimave përkatëse që ndihmojnë në koagulimin e qumështit dhe formimin e masës së djathit.

Ndarja e hirrës dhe shpërndarja në formë: Pas rreth 30 minutash, bëhet ndarja e hirres nga masa e ngurtë. Masa e ngurtë shpërndahe në format përkatëse për të formuar djathin.

Shellirosja në kripë: Pas ndarjes, djathi vendoset në një solucion 8% kripë për 24 orë, duke mundësuar ruajtjen dhe zhvillimin e shijes karakteristike.

Stazhimi: Djathi i bardhë qëndron në stazhimin për 14 ditë, për të zhvilluar shijen dhe konsistencën e duhur.

Kontrolli dhe paketimi: Pas periudhës së stazhit, bëhet kontrolli final i parametrave të cilësisë dhe paketimi i djathit për shpërndarje.

Hedhja në treg: Pasi janë kryer të gjitha proceset dhe kontrollohet cilësia, djathi është i gatshëm për të dalë në treg dhe për t'u shpërndarë te konsumatorët. Skema në vijim paraqet etapat e prodhimit të djathit.




Figura 17: Skema teknologjike e prodhimit të djajtit

Ajka (kremit i qumështit)

Ajka është një nënprodukt i qumështit me përmbajtje të lartë yndyre, e përftuar përmes ndarjes mekanike të fazës lipidike nga qumështi (procesi i centrifugimit). Përbërja përfshin: Ajka është burim i mirë i vitaminës A dhe përmban sasi të dobishme të riboflavinës (vitamina B2). Kjo e bën atë të vlefshme si për përdorim ushqimor, ashtu edhe për përgatitje kulinare me funksione organoleptike të veçanta (teksturë, shije, aromë).



Figura 18: Djathë i bardhë Drena



Figura 19: Ajkë me specia Drena

3.4.7 Laboratori

Laboratori i analizës së qumështit është një mjedis i specializuar ku realizohen një sërë testesh fiziko-kimike, dhe sensorike me qëllim vlerësimin e cilësisë dhe sigurisë së produktit. Në këtë laborator kryhen analiza si përmbajtja e yndyrës, proteinave, laktozës, densiteti, pH-ja. Pajisjet moderne dhe metodologjitë e standardizuara sigurojnë rezultate të sakta dhe të besueshme, që janë thelbësore për kontrollin cilësor të lëndës së parë dhe të produkteve të përfunduara. Roli i këtij laborator është thelbësor në garantimin e përputhshmërisë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë ushqimore.



Figura 20: Cryoscope -Pajisje për përcaktimin e ujit dhe pikës së ngrirjes



Figura 21: Gerber - Pajisje për përcaktim të yndyrës



Figura 22: Laktoskan



Figura 23: Përcaktues i Antibiotikut



Figura 24: pH -Metër

3.4.8 Çmimet

Qumështorja Drena synon të ofrojë produkte me çmime të arsyeshme dhe të përballueshme, me qëllim që të gjithë qytetarët të kenë qasje të barabartë në konsumimin e produkteve të saj. Strategjia e çmimeve është ndërtuar mbi parimin e afrimit me konsumatorin dhe rritjes së pranisë së markës në çdo familje. Përcaktimi i çmimit të produkteve finale bazohet në një metodologji të zakonshme për ndërmarrjet prodhuese, e cila përfshin analizën e kostos së lëndës së parë, kostos së prodhimit, humbjeve dhe mbetjeve gjatë procesit prodhues, si dhe shpenzimeve të transportit. Këtyre elementeve u shtohet përqindja e fitimit, duke u siguruar që çmimi përfundimtar të jetë konkurrues dhe i qëndrueshëm në treg. Kjo qasje pasqyron përpjekjen e ndërmarrjes për të balancuar qëndrueshmërinë ekonomike me përgjegjësinë sociale ndaj konsumatorëve.

3.4.9 Promocioni

Në krahasim me vitet e para të themelimit, strategjia promovionale e qumështores Drena ka pësuar një zhvillim të dukshëm, duke u përshtatur me trendet moderne të komunikimit dhe marketingut. Promocioni televiziv ka luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen e vetëdijes së konsumatorëve, duke i informuar ata në mënyrë të vazhdueshme për gamën e produkteve dhe risitë që kompania sjell në treg.

Një tjetër mjet efektiv në promovimin e produkteve është faqja zyrtare e internetit, e cila shërben si një burim i besueshëm informacioni për konsumatorët. Për çdo produkt të Drenës janë të përshkruara përbërja, vlerat ushqyese dhe dobitë shëndetësore, duke ndihmuar

konsumatorët të marrin vendime të informuara. Gjithashtu, përmes faqes së internetit, konsumatorëve u ofrohet mundësia të shprehin pyetje, komente, kritika apo sugjerime, çka tregon përkushtimin e kompanisë ndaj ndërtimit të një komunikimi të dyanshëm dhe transparent.

Përveç kësaj, rrjetet sociale si Facebook dhe Instagram luajnë një rol të rëndësishëm në afërsinë me konsumatorët, duke ofruar informacione të shpejta dhe interaktive rreth produkteve, aktiviteteve dhe nismave të reja të qumështores. Nëpërmjet këtyre kanaleve, Drena është bërë më e qasshme dhe më e afërt me publikun, duke forcuar lidhjen me bazën e saj të konsumatorëve.

3.4.10 Distribrimi

Qumështorja Drena synon të ofrojë produkte të pakrahasueshme, duke u fokusuar njëkohësisht në cilësinë dhe në shërbimin ndaj konsumatorit. Me produkte të freskëta dhe 100% natyrale, Drena ka arritur të zgjerojë praninë e saj në të gjitha qytetet e Kosovës, duke u bërë një emër i njohur dhe i besuar në tregun vendor. Produktet e saj janë lehtësisht të qasshme në rrjetet kryesore të shitjes me pakicë, përfshirë ETC, Viva Fresh, Interex, Deppo Market, Conad dhe KAM, gjë që dëshmon për shpërndarjen efikase dhe përkushtimin e kompanisë për të qenë sa më afër konsumatorëve në çdo cep të vendit. Kjo qasje strategjike e bën Drenën jo vetëm lider në prodhimin e produkteve të qumështit, por edhe një partner të përditshëm në tryezat e qytetarëve.

3.4.11 SWOT analiza e qumështores Drena

Analiza SWOT shërben si një instrument strategjik për të maksimizuar përdorimin e burimeve dhe aftësive të disponueshme në funksion të avantazhit konkurrues të një biznesi. Ajo mundëson identifikimin dhe shfrytëzimin optimal të pikave të forta dhe mundësive, ndërkohë që ndihmon në adresimin e mangësive të brendshme dhe reduktimin e ndikimit të faktorëve të jashtëm të rrezikshëm. Në këtë mënyrë, minimizohen shanset për dështim, duke ofruar një kuptim më të thelluar të sfidave dhe duke ndihmuar në ndërmarrjen e veprimeve të qëllimshme për t'i shmangur ato.




Figura 25: SWOT Analiza

3.5. Përshkrimi i alternativave të mundshme të projektit

Përshkrimi i alternativave të arsyeshme të studiuara nga aplikuesi që janë relevante për projektin e fabrikës për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij me veçoritë specifike të tij si dhe përshkrimin e arsyeve kryesore për opsionin e zgjedhur duke marrë parasysh pasojat mjedisore të projektit, janë bazuar kryesisht në vlerësimin e mundësive dhe kufizimet gjatë zhvillimit të projektit të tillë, duke ditur që është një projekt specifik.

Meqë projekti (qumështorja Drena) ka qenë në operim në kohën kur është përgatitur vlerësimi i ndikimit në mjedis alternativat tjera për lokacione të mundshme nuk kanë qenë opsion që të analizohen. Por duke marrë parasysh lokacionin aktual ku shtrihet projekti në ZK Klinë të Poshtme, të Skënderajt, i cili gjendet në rrugën magjistrale Skënderaj – Klinë e Poshtme, ky lokacion vlerësohet me përparësi të madhe. Përparësitë e këtij lokacioni janë: qasja e menjëhershme në rrugën magjistrale, lehtë dhe e frekuentuar nga shumë makina në lëvizje, zona

është tipike biznesore (sipas HZK të komunës së Skënderajt është zonë industriale e lehtë – ZIL), dhe ka edhe objekte tjera afariste e biznesore si dhe industriale në këtë lokacion.

Alternativat në aspektin e sigurisë, po ashtu në këtë lokacion vlerësohen me përparësi të dukshme. Edhe alternativat e këtij lokacioni në aspektin mjedisor janë të qëndrueshme, sepse kemi të bëjmë me zonë tipike industriale – biznesore.

Gjithashtu, alternativë e qëndrueshme e këtij projekti është edhe aspekti ekonomik, i zhvillimit të biznesit, në harmoni me mjedisin dhe sigurinë – pra zhvillimin e qëndrueshëm.

4. PËRSHKRIMI I ASPEKTEVE MJEDISORE EKZISTUESE

4.1. Popullata - vendbanimi dhe infrastruktura

Njërën nga veçoritë qenësore të hapësirës së analizuar, në kuptim të përcaktimit të ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqet popullata dhe demografia e saj. Këto fakte kuptimin e plotë të tyre e kanë në hulumtimin e hollësishëm të ndikimeve të mundshme negative në banorë që jetojnë në hapësirën e analizuar.

Sipas vlerësimeve, aktualisht në Komunën e Skënderajt jetojnë 51,317 banorë, që përbëjnë rreth 3% të banorëve të Kosovës. Prej numrit të gjithmbarshëm të banorëve në komunë, 6612 (rreth 13%) jetojnë në zonën urbane, dhe 87% që jetojnë në zona rurale. Përveç numrit të banorëve rezident, vlerësohet se janë edhe rreth 15.000 persona nga Skënderaj të cilët jetojnë jashtë vendit.

Dendësia e popullsisë në zonën urbane është të 142.9 banorë për km², ndërsa në zonat rurale është 119.7 banorë për km² pothuajse e njëjtë me nivelin e Kosovës - 177.4 banorë për km².

Mosha dhe gjinia - Në Komunën e Skënderajt, pjesëmarrja e popullsisë me grupmoshë prej 0-20 vjet është 47%, me grupmoshë 20-60 vjet është 48%, dhe mbi 60 vjet është 5%. Karakteristikë e Komunës së Skënderajt është dominimi i moshës së re me 47%, dhe kjo paraqet një potencial të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të saj në të ardhmen.

Sa i përket raporti gjinor në përbërjen e popullsisë në Komunën e Skënderajt, struktura gjinore është si vijon: meshkuj – 25, 879, ose 50,4%; dhe femra – 25,438 ose 49,6%.

Përkatësia etnike - Shumica e popullsisë në Komunën e Skënderajt është shqiptare me 99.81%. Pjesëtarë të nacionalitet serb janë 50 banorë (0,13%), të nacionalitet boshnjak 42 banorë (0.03%), të komunitetit ashkali janë 10 (0.01%), goranë 1 dhe turk 1, ndërsa 4 banorë (0,03%) janë të padëklaruar.

Pra, edhe lokacioni ku do të shtrihet projekti i Qumështores Drena - fabrikës për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij ka infrastrukturë të mirë rrugore (e përmendur edhe më lart), si dhe afër lokacionit ku ndodhet fabrika Drena është në dispozicion edhe infrastruktura ujore, energjetike dhe infrastruktura tjetër përcjellëse.

4.2. Klima

Në komunën e Skënderajt si makroklime mbizotëron klima kontinentale me verëra të nxehta dhe me dimra shumë të ashpër dhe të ftohtë. Meqenëse komuna ka një terren kodrinor – malore

me siguri ka edhe mikroklima të caktuara në pjesë të caktuara të territorit të saj, por në mungesë të një stacioni meteorologjik nuk ka të dhëna të sakta. Të dhënat për kushtet klimatike të komunës merren nga stacioni meteorologjik i Mitrovicës.

- Temperatura mesatare vjetore është 10 °C
- Muaji me i nxehtë është Korriku dhe Gushti me 20.4 °C
- Muaji me i ftohtë është Janari me – 1.34 °C
- Maksimumi absolut arrihet në Gusht me mbi 36.4 °C
- Minimumi absolut arrihet në shkurt -25.24 °C.

Erërat dominuese në Skenderaj kanë drejtimin e veriperëndimit. Erërat verore dhe pranverore fryjnë nga jugu. Shpejtësitë mesatare më të mëdha të erërave janë:

- Perëndimore 9.3 m/sec;
- Verilindore 4.2 m/sec;
- Veriperëndimore 3.8 m/sec;
- Jugore 2.8 m/sec dhe
- Lindore 1.6 m/sec.

Në komunë gjatë vitit të reshurat mesatare janë 604.8 mm

- Vjetorja maksimale 850.9 mm (të reshura)
- Vjetorja minimale 394.9 mm (të reshura)
- Ditët më të hershme 5.11
- Ditët më të vonshme 3.05

Lagështia relative mesatare vjetore e ajrit është 71.4%. Lagështia relative mesatare sipas stinëve në verë është 62.5%, në pranverë 68.5%, në vjeshtë 72.6% dhe në dimër 81.6%.

4.3. Karakteristikat hidrografike

Terreni në të cilin është komuna e Skenderajt i takojnë slivit të Detit Adriatik. Në lindje të komunës rrjedh lumi Klina, rrjedha e majtë e Drinit të Bardhë. Në lindje dhe juglindje rrjedhin lumenjtë: Sitnica dhe Drenica.

Lumi “Klina” buron në fshatin Kuqicë dhe përshkon territorin në aksin veri jug dhe kalon nëpër tërë territorin e Komunës si dhe në qendrën e qytetit të Skënderajt me një rrjedhë të ngadalshme, me një thellësi mesatare dhe një gjatësi prej 40 km. Gjithashtu nëpër territorin e komunës ka edhe një numër të madh përroskash të cilat në tërësi derdhen në lumin “Klina”. Rrjedhat e lumenjve nuk i rrezikojnë vendbanimet sepse ato deri më tani nuk kanë dalur nga shtrati i tyre.

Në territorin e Komunës së Skënderajt nuk ekziston asnjë liqen, as natyrorë por as edhe artificial, përpos disa rezervateve të ujit të cilët edhe ata janë në numër të vogël.

Në afërsi të lokacionit ku shtrihet projekti i qumështores Drena nuk ka ndonjë burim uji që kishte me pas ndikim në të projekti i qumështores.

4.4. Karakteristikat pedologjike dhe shfrytëzimi i tokës

Komuna e Skenderajt shtrihet në terrenin me përbërje të llojllojshme pedologjike. Në bazë të shënimeve nga Plani Urbanistik i vitit 1974 shihet se territori i ngushtë i qendrës së qytetit ka një përbërje ranore, me prezencën e karbonateve, Aluvininë, ndërsa në pjesët tjera të terrenit të komunës përbërja e tokës është humusore dhe smonicë. Cilësia e tokës variron nga toka e klasës së parë deri te toka e klasës së V-të.

Kategoritë e tokës - Sipas shënimeve kadastrale dhe studimeve të mëhershme toka e komunës përfshihet në kategoritë I deri në VI si dhe tokën e pa-kategorizuar jopjellore (tokë shterpë). Një pjesë shumë e vogël me afro 10% të sipërfaqes së gjithmbarshme bënë pjesë në kategorinë e II-të dhe të I-rë, ndërsa pjesa dërmuese bënë pjesë në kategorinë e V dhe të VI-të.

Shfrytëzimi i tokës - Në komunën e Skënderajt ka një përzierje të sipërfaqeve pyjore, sipërfaqe bujqësore – ara, sipërfaqe kullosa, sipërfaqe kodrinore, si dhe mes tyre zonat e ndërtuara. Komuna e Skënderajt ka gjithsej 12.352.763 m² tokë bujqësore (rurale) të evidentuar si të tillë (DUKMM, KK Skënderaj) dhe të pa kategorizuar 361.337.735 m² (pyje, lumenj, etj.).

4.5. Karakteristikat sizmike të komunës së Skënderajt

Komuna e Skënderajt bënë pjesë në dy zona sizmike:

- ✓ Në zonën me dridhje prej VI shkallë të Rihterit, dhe
- ✓ Në zonën me dridhje prej VII shkallë të Rihterit.

Në zonën prej VI shkallë të Rihterit bënë pjesë 5/6 e sipërfaqes së përgjithshme të Komunës në përgjithësi. kryesisht pjesa perëndimore e komunës.

Në zonën prej VII shkallë të Rihterit bënë pjesë 1/6 e sipërfaqes së përgjithshme të Komunës kryesisht pjesa lindore e komunës.

Në bazë të karakteristikave gjeodezike dhe karkteristikave të zonës sizmike Skënderaji paraqet një mesatare të dridhjeve sizmike.

4.6. Ndotja dhe degradimi i mjedisit (ajri, uji, toka)

Ajri i pastër është me rëndësi vitale për shëndetin e njeriut. Mirëpo, që nga revolucioni industrial cilësia e ajrit që e thithim ka rënë konsiderueshëm - kryesisht si rezultat i aktiviteteve njerëzore. Ngritja e prodhimit industrial dhe energjetik, djegia e karburanteve fosile, si dhe rritja dramatike e trafikut kanë shtuar edhe më shumë ndotjen e ajrit, çka si rrjedhojë mund të shkaktojë probleme shëndetësore serioze.

Mjedisi ndotet edhe nga hedhurinat shtëpiake dhe të biznesit të vogël, sidomos në periudhën pas konfliktit. Shikuar në përgjithësi, as popullata nuk është nxitur të përkujdeset për mjedisin.

Kështu, hedhja e mbeturinave dhe derdhja e ujërave të zeza në lumenj bëhet pa ndonjë trajtim paraprak. Përdorimi i pesticideve, ujërat e kulluara nga aktivitetet bujqësore, numri i rritur i automjeteve personale dhe komerciale, sidomos në hapësirat më të mëdha urbane, dhe sistemi i ngrohjes së shtëpive private me dru ose thëngjill gjatë dimrit, po ashtu llogariten si ndotës të mjedisit.

Pluhuri mund të depërtojë nëpërmjet të reshurave në ujëra nëntokësore dhe në këtë mënyrë të shkaktojë ndotjen e resurseve ujore që janë në përdorim të popullatës. Ekzistojnë faktorë të shumtë që ndikojnë në ndotjen e ambientit. Si p.sh.: uzurpimet dhe përvetësimet e pronës shtetërore dhe private, duke ndërtuar objekte pa leje ndërtimi, nëpër toka bujqësore, sipërfaqe gjelbëruese dhe sipërfaqe të destinuara për infrastrukturë, pastaj duke dëmtuar monumente dhe lokalitete me vlera kulturore, historike dhe arkitektonike. Ndërtimi i objekteve të tilla është i rrezikshëm, si për ambientin (vendbanimet), ashtu edhe për njerëzit. Të tilla janë pompat e benzinës, depot e ndryshme, objektet ekonomiko-industriale që kanë teknologji të vjetruar dhe të dëmtuar, mbeturinat e natyrave të ndryshme, etj.

Ndotja e mjedisit është një problem mjaft serioz, prezent pothuaj kudo në territorin e Kosovës, e po ashtu edhe në komunën e Skënderajt. Ndotja dhe degradimi i mjedisit në këtë komunë bëhet më së shumti me:

- lëshimin e ujërave të zeza nga kanalizimet e vendbanimeve si dhe nga objektet industriale direkt në lumenj,
- hedhja e mbeturinave të ngurta pranë rrugëve dhe lumenjve ,
- prerja e drunjve dhe dëmtimi i pyjeve pa kriter.

Ajri – Edhe pse nuk monitorohet e nuk dihet se cilët përbërës dhe sa janë prezent në të, ai është i ndotur në qendrën urbane. Kjo ndotje shkaktohet nga pluhuri, si pasojë e djegies industriale si dhe komunikacioni (gazrat e liruara nga makinat e vjetra dhe pa katalizator). Kjo është zgjidhur

pjesërisht me devijimin/ndërprerjen e rrugës kryesore dhe krijimin e bulevardit/sheshit ‘Adem Jashari’.

Uji – Disa vendbanime kanë probleme sepse nuk kanë qasje në sistemin e ujësjellësit dhe ujin e pijes e marrin nga puset individuale apo kolektive, të cilat shpesh nuk i përmbushin kriteret për furnizim me ujë të pijes. Këto puse nuk janë të ndërtuara si duhet dhe ndodh të ndoten nga ujërat sipërfaqësor (si ujëra të zeza apo të kulluara) gjë që përbën një rrezik të vazhdueshëm për shëndetin e popullatës.

Burimi kryesor i ndotjes së lumenjve në komunë janë ujërat e kanalizimit, si pasojë e sistemit të pakompletuar dhe joadekuat të menaxhimit të tyre. Ky rrjet shkakton derdhjen e ujërave të zeza pa trajtim paraprak, me një ndikim negativ në cilësinë e ujit si dhe në jetën bimore dhe shtazore. Pasojat e kësaj ndotje mund të shkojnë edhe më tej duke shkaktuar ndikime negative në tokë dhe në ajër. Si përgjigje ndaj kësaj dukurie, dhe me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore, komuna është duke e ndërtuar sistemin kryesor të kanalizimit ku do të përfshihen rreth 70% të fshatrave të komunës së bashku me qytetin e Skënderajt.

Toka – Mbeturinat e ngurta të akumuluar në deponitë ilegale janë ndër ndotësit kryesorë të tokës në komunë. Këto janë kryesisht deponi ilegale të mbeturinave shtëpiake, dhe në disa raste mbetjeve të ndërtimit, të cilat kryesisht gjenden në afërsi të rrugëve. Ndikimet negative të këtyre deponive janë të shumta, ku përveç kontaminimit të drejtpërdrejtë të tokës dhe ajrit, ndikimi i tyre mund të bartet në rrjedhat e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë nëpërmjet reshjeve. Drejtoria e Shërbimeve Publike për çdo vit e bën evidentimin e deponive ilegale dhe organizon pastrimin e tyre. Në mungesë të një sistemi të kompletuar dhe të mjaftueshme të kanalizimit, ujërat e zeza duhet të trajtohen si ndotës potencial të tokës. Kjo ndotje mund të shkaktohet nga kalimi i ujërave të zeza në zonat e ujit sipërfaqësor apo rrjedhave nëntokësore, varësisht nga forma e shkarkimit të tyre - drejtpërdrejtë në rrjedhat e ujit (në shumicën e rasteve) ose në sipërfaqen e tokës.

Përveç ndotjes së drejtpërdrejtë, si një formë tjetër e degradimit të tokës është ndryshimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Po ashtu, problem të veçantë paraqet edhe degradimi i pyjeve përmes prerjes ilegale.

Ndërsa, vetë projekti i qumështores është një projekt moderues sa i përket kontributit në keqësimin e gjendjes së mjedisit në zonën ku do të shtrihet (pasi që edhe sipas HZK-së së Skënderajt në këtë zonë lejohen të operojnë projektet e industrisë së lehtë), por me marrjen e

masave zbutëse efektet e dëmshme të mundshme nga ky projekt do të minimizohen në maksimum.

4.7. Ujërat

Ekonomia ujore dhe rrjedhat - Komuna e Skenderajt ka rrjetë mjaftë të zhvilluar hidrografike, gjegjësisht ka numër mjaftë të madh të lumenjve (përroskave) që kalojnë në territorin e komunës.

Lumenjtë e vegjël janë lumenj me tipare karakteristike për përroskat malore, që d.m.th. lumenj të vegjël, me oscilime shumë të mëdha të sasisë së ujit gjatë vitin. Gjatë kohës së thatë në shumicën e këtyre lumenjve ka shumë pak ujë ose nuk ka ujë fare, kurse gjatë kohës me reshje shpesh ndodh që të ketë vërshime lokale.

Lumi më i madh i komunës dhe arteria kryesore hidrografike është lumi Klina. Ky lumë burimin e vetë e ka nga ujërat nëntokësore të maleve mbi Skënderaj. Lumi Klina është një ndër degët e majta të lumit, më të madh në Kosovë, Drini i Bardhë. Sipërfaqja e pellgut të Klina është $F = 423 \text{ km}^2$, kurse gjatësia e lumit është $L = 60.0 \text{ km}$. Lumi Klina kalon nëpër qytetin e Skënderajt. Mbi gjysma e sipërfaqes së pellgut janë toka punuese dhe livadhe e kullosa, mirëpo ka shumë sipërfaqe me djerrina, 8% male, etj.

Gjatë vitit 2009 është punuar projekti për rregullimin e shtratit të lumit Klina i cili e ndanë qytetin nga ana lindore dhe perëndimore. Dhe gjatë këtij viti janë bërë investime në rregullimin e shtratit të lumit në zonën urbane. Sipas të dhënave gojore nga banorët e Skënderajt ky lumë bën përmbytje një herë në vit dhe bën dëme të konsiderueshme. Pos lumit Klina, në kohë të shirave janë të pasur me ujë edhe lumenjtë më të vegjël, si Prroni i Keq, Lumi i Rezallës, Likocit, Runikut, etj.

Furnizimi me ujë të pijshëm - Furnizimi me ujë i qytetit të Skënderajt sipas drejtorisë për Urbanizëm të Komunës së Skenderajt, nuk është në gjendje të mirë; në disa pjesë të qytetit ky sistem është ndërtuar që në vitin 1963, mirëpo falë ndihmës së donatorëve të ndryshëm është bërë rehabilitimi i disa pjesëve, si dhe rritja e kapacitetit të pompimit në rezervuarin kryesor në Shipol. Në periudhën e pasluftës, vitet 1999-2003, është bërë ndërtimi i rrjetit të ri të ujësjellësit në Skënderaj me një gjatësi prej afro 1,300 m me gypa tip DIN 200. Ndërsa, nga viti 2003 është bërë përgatitja për rehabilitimin e afro 900 m të sistemit të ujësjellësit. Gjatësia e tërësishme e rrjetit të ujësjellësit në qendër të qytetit është afro $L = 7,500 \text{ m}$. Gjatësia e rrjetit prej Fabrikës së Ujit në Shipol deri të rezervuari është afro 22 km. Kapaciteti i mundshëm është 99 l/sec., ndërsa faktikisht ujë nga fabrika e ujit në Shipol për Skënderaj vjen 75 l/sec.

Kanalizimi fekal - Sipas shënimeve të unazës së Planit Urbanisti, qyteti i Skenderajt përmban një sistem të kanalizimit primar me një gjatësi prej 7258 m, i cili sistem është realizuar nga donatorë të ndryshëm dhe me pjesëmarrje nga komunitet dhe buxhet komunal, ndërsa sistemi i kanalizimit sekondar është në një pozitë tejet të vështirë, kështu që në bazë të kërkesave dhe nevojave duhet të arrihet realizimi i 5912 m të domosdoshme.

Kanalizimi atmosferik - Sa i përket kanalizimit atmosferik, qyteti ka një qasje të pamjaftueshme. Vetëm një numër i vogël i rrugëve posedon me këtë pjesë të infrastrukturës. Deri më tani, vetëm rruga “28 Nëntori” posedon kanalizim atmosferik me gjatësi 1300 m, është në realizim e sipër sistemi i kanalizimit atmosferik në rrugën “Ilaz Kodra” me gjatësi 500 m. Ndërsa, në zonën ku shtrihet projekti i qumështores nuk ka ndonjë burim uji.

4.8. Biodiversiteti dhe trashëgimia kulturore

Ndryshueshmëria midis organizmave të gjallë që jetojnë në ekosistemet tokësore, detare dhe ekosisteme të tjera ujore dhe komplekset ekologjike në të cilat ato bëjnë pjesë, kjo përfshinë diversitetin brenda llojit, midis llojeve dhe ekosistemeve. E thënë me fjalë të tjera, termi diversitet biologjik shpreh numrin dhe gjithë larinë e organizmave të gjallë në planet. Brenda këtij termi përfshihet diversiteti i gjeneve, llojeve dhe ekosistemeve që janë produkt i një procesi evolutiv përmes tre (3) miliardë vjetëve. Njerëzimi dhe mbijetesa e tij varet nga ky diversitet biologjik. Në këtë kuptim termi diversitet biologjik është sinonim i termit “Jeta në planet”.

Komuna e Skënderajt karakterizohet me shumëllojshmëri në pikëpamje të përmbajtjes morfologjike, të klimës, përmbajtjes pedologjike, konfiguracionit të terrenit dhe lartësisë mbidetare e që kushtëzon llojllojshmërinë e botës bimore dhe shtazore.

Bota bimore - Bota bimore është e llojllojshme, kryesisht kultivohen drithërat si gruri, tërshëra, elbi, misri, thekra, etj. Sipërfaqe të mëdha gjinden nën pemishte, kurse një pjesë e konsiderueshme gjendet nën pyje, gjegjësisht male dhe dushkaja të cilat gjinden në tërë territorin.

Pylli është faktor dominant i hapësirës jetësore të njeriut, e këtë duhet shikuar si faktorë të domosdoshëm natyror e shoqëror të jetës dhe rregullator të jetës në tokë. Është i rëndësishëm funksioni i pyllit si rregullator i regjimit të ujit, pengimit të erozionit të tokës dhe vërshimeve të sipërfaqeve bujqësore e lagjeve, si faktorë të sigurimit të ajrit të pastër dhe pengimit të aerodotjes në vendbanime. Është i rëndësishëm ndikimi i pyllit në temperaturën e ajrit, tokës dhe shpejtësisë së erërave dhe në përgjithësi mund të thuhet se është ndikim i madh dhe i rëndësishëm i pyllit në gjendjen shëndetësore të njeriut dhe rekreacionin e tij. Prej sipërfaqeve

të përgjithshme nën pyje në komunë 2.0% përbëjnë pyjet e larta, 19.9% të ulëta gjersa pyjet e degraduara dhe dushkaja përbëjnë 78.1%. Përveç bungut gjendet edhe frashri, shelja dhe dardha e egër. Prej llojeve të çubave takohen: therra, gjyli i egër, dhe shumë barishta të tjera.

Bota shtazore - Bota shtazore është e pasur dhe e shumëllojshme. Shumica e prodhuesve bujqësor rrisin kryesisht: lopë, dele, kuaj dhe shpezë. Në territorin e Skenderajt është i përfaqësuar edhe një numër i madh i egërsirave siç janë: derri i egër, dreni, thëllëza, lepur, ujku, dhelpra dhe sqarfi. Këto lloje të egërsirave janë të përshtatshme për zhvillimin e gjuetisë. Fushat e gjuetisë janë të përshtatshme por mungojnë stazat e gjuetisë e mungojnë edhe objektet dhe mjetet e gjuetisë në mënyrë që të ruhet dhe rritet fondi i egërsirave.

Në këtë drejtim duhet paraparë masat për rregullimin e vendqëndrimeve të egërsirave, shtëpive të gjuetisë, kasollet, vend-ushqimet, vendstrehimet për dimër për thëllëza, etj.

Sipas pozitës gjegjëse të komunës dhe morfologjisë së terrenit takohen lloj zogjsh të cilët i janë përshtatur jetës në këtë territor e këto janë: rosa e murrme, kredhi i vogël, çopkë e murrme, e zezë, e natës, krahëthatë, thëllëza, pëllumbi i egër, turtulla, kumria, qyqja (e cila e bënë folenë në malet e ulëta dhe ato të bjeshkëve), huti i madh, korbi, etj.

Trashëgimia natyrore - Për nga trashëgimia natyrore, komuna e Skënderajt është e pasur me trungje bingu, trungje qarri, trungje drunjsh të ndryshëm si dhe burim të ujit termal dhe burim të ujit të njelmët, të shpërndarë sipas hartës në vijim.

Gjatë periudhës 1999- 2004 Instituti për Mbrojtjen e Natyrës së Kosovës - ka bërë evidentimin e vlerave të reja të natyrës. Njohja dhe evidentimi i vlerave të reja të natyrës është kryer në 12 komuna edhe atë në: Gjakovë, Skenderaj, Drenas, Burim, Rahovec, Kastriot, Vushtrri, Gjilan, Malishevë, Mitrovicë, Klinë dhe Podujevë. Gjatë këtij procesi janë Në komunën e Skënderajt janë evidentuar 13 zona të propozuara për mbrojtje.

Zonat e veçanta të mbrojtura - Në kuadër të komunës së Skënderajt ekziston Manastiri i Deviqit si zonë e veçantë e mbrojtur, si dhe kompleksi memorial "Adem Jashari".

Në lokacionin ku shtrihet qumështorja Drena me aktivitetin e saj nuk ka direkt ndonjë monument apo zonë të mbrojtur.

5. PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS

Analiza e vlerësimit të gjendjes ekzistuese të mjedisit si dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme të cilat janë si pasojë e aktiviteteve gjatë funksionimit të ‘fabrikës për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij’ në Klinikë të Poshtme të Skënderajt, tregojnë se deri të kuantifikimi i të dhënave mund të vije sipas një analize gjithëpërfshirëse. Të gjitha ndikimet e mundshme nuk janë të vlerave të njëjta që të bëhet edhe kuantifikimi i tyre.

Ndikimet në mjedis mund të lajmërohen në të gjitha fazat e zhvillimit të projektit (ndërtimit dhe operimit), prandaj të gjitha ndikimet e mundshme negative në mjedis i klasifikojmë në dy periudha themelore dhe atë:

- ✓ Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis për fazën e ndërtimit të projektit, si dhe
- ✓ për fazën e zhvillimit të aktiviteteve ku planifikohet të operoj projektin.

Metoda e zbatuar për parashikimin e ndikimeve në mjedis

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqën hapat e më poshtëm:

- Njohja me projektin dhe përshkrimin teknik të tij.
- Njohja me vlerën natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes ku do të zhvillohet aktiviteti.
- Njohja me infrastrukturën ekzistuese dhe nevojën për infrastrukturë të re për projektin.
- Njohja me aktivitetet që do të përdoren për zhvillimin e aktivitetit.

Duke njohur teknologjinë apo përshkrimin teknik të zhvillimit të projektit në fjalë u identifikuan ndikimet e mundshme negative në çdo receptorë - përbërës të mjedisit në lidhje me projektin.

Identifikimi i ndikimeve – Përmes të cilit u përcaktua ndërveprimi mjedis-projekt i projektit dhe u identifikuan ndikimet e mundshme gjatë fazës që do të ndërtohet projektin dhe aktiviteti sipas receptorëve të mjedisit.

Vlerësimi i ndikimeve – Vlerësimi i ndikimeve më të rëndësishme ka të bëjë me vetë rëndësinë e ndikimeve dhe është faza më e rëndësishme për zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe përaftron atë me objektivisht me tërësinë e bashkëveprimeve midis projektit dhe mjedisit. Kriteret e përdorura për vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve ndryshojnë dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit të ndikuar.

Shtrirja fizike dhe kohëzgjatja e ndikimeve të identifikuara (shkalla)

Shtrirja fizike - Vlerëson sipërfaqen apo dimensionin hapësinor të një ndikimi të dhënë në raport me burimin që gjeneron atë ndikim, p.sh. ndikimi në tokë nga ndërtimi i një projekti të caktuar.

Kohëzgjatja e ndikimit – Vlerëson se sa do të zgjasë një ndikim i caktuar në dimensionin kohë (ndikim i përhershëm apo i përkohshëm).

Kthyeshmëria – Vlerëson mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar në gjendjen e tij të mëparshme (aftësia për t'u rehabilituar dhe regjeneruar).

Rëndësia – Realizon një vlerësim total të tre përmasave të mësipërme dhe njëkohësisht thekson vëmendjen që duhet pasur për administrimin e ndikimit. Ndikimet e parashikuara nuk kanë shtrirje të madhe fizike. Zhurmat që krijohen gjatë proceseve të punës nuk përbëjnë ndotje akustike meqë procesi zhvillohet në hapësirë të mbyllur përbrenda objektit të fabrikës.

Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis për fazën e ndërtimit të fabrikës për prodhimin e produkteve të qumështit nuk do të bëhet sepse në kohën kur është hartuar ky raport i VNM-së, fabrika/qumështorja ka qenë e ndërtuar.

Ndikimet e identifikuara nga zhvillimi i aktivitetit/projektit janë ndikime direkte në mjedis.

5.1. Ndikimet në ajër

Gjatë fazës së zhvillimit të aktiviteteve prodhuese në fabrikën/qumështoren DRENA për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij, ndotje e ajrit mund të ndodhë nga gazrat të cilët lirohen nga djegia e lëndës djegëse mazutit, gazit apo naftës që nevojiten për realizimin e proceseve teknologjike për procesin e prodhimit, e cila ndotje është minimale.

Ndotja e ajrit ndodhë nga aroma e pakëndshme që lirohet gjatë realizimit të proceseve teknologjike për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij. Ndotja e ajrit vjen edhe gjatë lirimit të gazrave rast kur punon/përdoret gjeneratori (edhe pse është jashtë funksionit që një kohë të gjatë). Ndotja e ajrit ndodhë nga gazrat të cilët lirohen nga automjetet transportuese, që nevojiten për transportimin e lëndës së parë qumështit që nevojitet për realizimin e prodhimit të produkteve të qumështit. Ndotje e ajrit ndodh nga gazrat të cilët lirohen nga automjetet e udhëtimit.

Gazrat të cilët lirohen nga djegiet e lëndës djegëse, djegiet motorike përmbajnë një numër të madh të komponentëve ndotëse me koncentracione të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë CO, NO_x, HxCy, SO₂ dhe Pb. Ndikimi i tyre në shkallën e ndotjes varet para se gjithash nga kushtet klimatike – meteorologjike dhe dendësisë së qarkullimit të komunikacionit në lokacionin në fjalë.

Ndotje e ajrit mund të ndodhë edhe nga aroma e pakëndshme që mund të lirohet nga rrjeti i kanalizimit dhe gropa septike për ujërat e zeza (impianti), në rast të ndonjë dëmtimi të tyre,

andaj duhet të jenë të izoluara mirë ashtu që të mos ketë rrjedhje direkte në tokë dhe të bëhet evitimi i plotë i erërave.

5.2. Ndikimet në tokë

Toka (dheu) si element themelor natyror është kusht ekologjik për rritjen dhe ekzistimin e bimëve, toka është element për prodhimin e ushqimit dhe ekzistimin e ekosistemit malor të cilët janë të nevojshëm për arritjen dhe mbajtjen e bilancit ekologjik (produktimit dhe ndërtimit të materieve), posaçërisht për mbajtjen e stabilitetit mjedisor. Toka është e domosdoshme edhe për funksione teknike në këtë rast për ndërtimin e fabrikës për përpunimin e qumështit si dhe prodhimin e produkteve të qumështit.

Gjatë fazës së zhvillimit të aktiviteteve prodhuese në fabrikën për përpunimin e qumështit dhe prodhimin e produkteve të tij ndodhja e tokës ndodhë: nga mbeturinat e lëngëta që përbëjnë yndyra të cilat shkaktohen nga larja e pajimeve të procesit teknologjik për përpunimin e qumështit dhe prodhimin produkteve të qumështit, nga larja e rezervarëve dhe enëve që nevojiten për bartjen e qumështit, nga larja e hapësirave prodhuese dhe deponuese të qumështit dhe produkteve të qumështit.

Ndikime tjera me rëndësi në tokë mund të paraqiten nga mundësia e derdhjes së karburanteve që përdoren për proces të prodhimit: gazi, mazuti, nafta, nga mundësia e derdhjes në sistemin e pompave, sistemin e gypave gjatë mbushjes dhe zbrazjes së rezervuarit gjerë në kaldajë dhe në hapësirat e kaldajës, nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve nga automjetet transportuese, që nevojiten për transportimin e lëndës së parë qumështit që nevojitet për realizimin e prodhimit të produkteve të qumështit, si dhe transportimin e produkteve të qumështit të prodhuar, si dhe nga automjetet e parkuara në parkingun e fabrikës, nga pluhurat që lirohen nga sipërfaqet punuese, nga mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët, nga mbeturinat e materialeve ambalazhuese.

5.3. Ndikimet në ujë

Ndikime negative në ujë shkaktohen nga mbeturinat e lëngëta që përbëjnë yndyra të cilat shkaktohen nga larja dhe dezinfektimi i pajimeve të punës dhe hapësirave operationale gjatë realizimit të procesit teknologjik për përpunimin e qumështit dhe prodhimin produkteve të qumështit, nga larja dhe dezinfektimi i rezervarëve dhe enëve që nevojiten për bartjen e

qumështit nga larja dhe dezinfektimi i hapësirave prodhuese dhe deponuese të qumështit dhe produkteve të qumështit.

Ndikime negative në ujë shkaktohen nga mundësia e derdhjes të mazutit nga rezervuari, nga mundësia e derdhjes në sistemin e pompave, sistemin e gypave gjatë mbushjes dhe zbrazjes së rezervarit gjerë në kaldajë dhe në hapësirat e kaldajës, nga mundësia e derdhjes së naftës, e cila nevojitet për furnizim të generatorit dhe kaldajës me naftë.

Ndikime negative në ujë shkaktohen nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve nga automjetet transportuese, që nevojiten për transportimin e lëndës së parë qumështit që nevojitet për realizimin e prodhimit të produkteve të qumështit, si dhe transportimin e produkteve të qumështit dhe nga automjetet e parkuara në parkingun e fabrikës, me derdhjen e tyre në tokë ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore me rastin e të reshurave atmosferike.

Gjatë fazës së zhvillimit të aktiviteteve të operimit ndotje e ujit mund të ndodh nga derdhja e mundshme e derivateve dhe vajit nga makineritë operuese në lokacion, derdhja e ujërave të zeza, larja e platos/ve të objektit, etj. Ndikim tjetër negativ mund të ketë nga ujëmbledhësit, gypat e kanalizimit, dhe gropa septike (impianti) për ujëra të zeza.

5.4. Ndikimi në peizazh

Duke pasur parasysh pozitën e lokacionit, formën, madhësinë dhe pozitën e vendosjes së objekteve të fabrikës (siç është treguar në nënkapitullin 3.3 – Përshkrimi i vendndodhjes së projektit), ku kjo zonë bën pjesë në zonën industriale të lehtë (ZI-L) sipas HZK të Skënderaj, si dhe duke pasur parasysh ekzistimin e objekteve industriale dhe objekteve afariste në këtë lokacion edhe më herët (si mulliri elektrik, fabrika e prodhimit të bllokave, etj.), andaj fabrika me objektet përcjellëse për përpunimin e qumështit dhe prodhimin e produkteve të qumështit është e ndërtuar në këtë zonë industriale të lehtë që do të thotë se ekzistojnë objekte afariste dhe industriale të ndërtuara të më hershme dhe në efektet vizuale nuk do të ketë ndikime negative ngase syri i njeriut është mësuar me këtë gjendje të objekteve afariste dhe industriale, gjegjësisht me këtë gjendje të mjedisit.

5.5. Ndikimi në florë dhe faunë

Sipas analizave të bëra deri tani në lidhje me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës mundë të vie deri të ndikimet në florë dhe faunë. Mirëpo, sipas gjendjes faktike në terren respektivisht në lokacionin

e caktuar nuk kemi zhdukje të madhe të vegjetacionit përpos nga sipërfaqet operationale të objekteve të fabrikës. Siç u përmend edhe më lart, në këtë zonë urbane tashmë ka operim të disa fabrikave apo industrive të lehta si dhe objekte tjera afariste e komerciale.

Operimi i fabrikës me infrastrukturë përcjellëse në këtë lokacion nuk do të ketë ndikime të theksuara në botën bimore. E njëjta do të vlente edhe për botën shtazore që do të thotë se nuk pritet të ketë ndikime negative, nga kryerja e aktiviteteve në fabrikën për përpunimin e qumështit dhe prodhimin e produkteve të qumështit, sepse në këtë lokacion nuk ekziston (zhvillohet) fauna për arsye se janë të ndërtuara objektet afariste dhe industriale dhe fauna është larguar nga ky lokacion dhe zhvillohet në lokacionin jashtë kësaj zone industriale.

5.6. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Ndërtimi dhe operimi i fabrikës për përpunimin e qumështit dhe prodhimin e produkteve të qumështit në këtë lokalitet pak të zhvilluar ekonomikisht, ka një rëndësi të veçantë për popullatën e këtij rajoni, për atë se pronari i kompanisë DRENA për të zhvilluar aktivitetet prodhuese për përpunimin e qumështit dhe prodhimin e produkteve të qumështit ka të punësuar dhe do të punësoj një numër të konsideruar të punëtorëve, gjithashtu duke pasur parasysh edhe numrin e fermerëve që paguhen nga kompania për furnizim të qumështit. Ndikime në aspektin e zhvendosjes e popullatës nga vendbanimet e tyre nuk ka nga ky projekt. Nga kjo që u tha më lart nga aktiviteti i fabrikës për përpunimin e qumështit dhe prodhimin e produkteve të tij në këtë lokalitet në aspektin e punësimit ka ndikime pozitive.

5.7. Ndikimet nga zhurma

Zhurma vjen si rezultat i aktivitetit të procesit teknologjik të qumështores për përpunimin e qumështit dhe prodhimin e produkteve të qumështit, nga automjetet transportuese që nevojiten për transportimin e lëndës së parë qumështit që nevojitet për realizimin e prodhimit të produkteve të qumështit, si dhe transportimin e produkteve të qumështit të prodhuara, mirëpo për shkak të pajimeve teknologjike të cilat janë të vendosura në hapësirat brenda objektit si dhe numrit të vogël të automjeteve transportuese që nevojiten për nevoja të fabrikës, krijimi i zhurmës nga fabrika me objektet përcjellëse është shumë i vogël dhe nuk ka ndikim të theksuar negativ në mjedis. Prandaj, si që u cek më lart aktiviteti i fabrikës për përpunimin e qumështit dhe për prodhimin e produkteve të qumështit në këtë lokalitet nuk do të ketë ndikime negative në aspektin e zhurmës.

5.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Për arsye të natyrës së aktiviteteve prodhuese në fabrikën për përpunimin e qumështit dhe prodhimin e produkteve të qumështit, aksidente mjedisore të mëdha nuk mund të ndodhin. Aksidentet të cilat mund të ndodhin, mund të jenë të natyrës së ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo kohë. Ne fazën e kryerjes së aktiviteteve prodhuese në fabrikën për përpunimin e qumështit dhe prodhimin e produkteve të qumështit aksidentet mund të ndodhin nga mundësia e shkaktimit të zjarrit, lëndimet e punëtorëve gjatë kryerjes të aktiviteteve prodhuese.

Aksidentet mund të ndodhin edhe nga mundësia e derdhjes të mazutit dhe naftës gjatë përdorimit në proces, nga mundësia e derdhjes së naftës gjatë mbushjes së rezervuarve dhe përcjelljes së mazutit dhe naftës në kaldaja, nga mundësia e shpërthimit të rezervuarve me mazut, naftë e gaz. Aksidentet mund të ndodhin nga rrjedhjet e lëndëve djegëse dhe lubrifikuese nga automjetet transportuese dhe nga mundësia e pëlcitjes së gypave hidraulik.

Sa i përket zjarrit mund të konstatojmë se realisht është e mundur por nuk do të bëjmë ndonjë analizë në detaje mbi vlerësimin e rrezikut nga zjarri duke pasur parasysh faktin se do të ekzistoj projektet kundër zjarrit dhe mbrojtja nga zjarri si dhe të gjitha masat preventive që duhet të ndermirren gjatë një aksidenti nga zjarri. Në rastet e aksidentit nga zjarri në lokacionin dhe rrethinën e fabrikës për përpunimin e qumështit dhe prodhimin e produkteve të qumështit mund të rrezikohet jeta dhe shëndeti i njeriut si dhe mjedisi rrethues.

Në pajtim me nenet e rregullores mbi metodologjinë për vlerësimin e rrezikshmërisë nga aksidenti kimik dhe nga ndotja e mjedisit, masat përgatitore dhe masat për eliminimin e pasojave (EPA) analiza e rrezikshmërisë bëhet në tri faza:

- Identifikimi i rrezikut
- Analiza e pasojave
- Vlerësimi i rrezikut

Identifikimi i rrezikut nënkupton procesin e mbledhjes së të dhënave mbi materiet e rrezikshmërisë në proces si dhe verifikimin e të gjitha pikave kritike të procesit dhe stabilimenteve.

Nuk pritet të ketë ndonjë aksident tjetër mjedisor nga aktivitetet që zhvillohen në zonë nga projekti.

6. MASAT PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE NË MJEDIS

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në mjedis dhe atë në ajër, tokë, ujë, në ruajtjen e peizazhit, si dhe në ruajtjen e shëndetit të njeriut, gjatë fazës së kryerjes së aktiviteteve operuese të projektit (përpunimi i qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij) duhet të merren masat që do të përshkruhen në vijim:

6.1. Masat për mbrojtjen e ajrit

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër gjatë fazës të zhvillimit të aktiviteteve prodhuese dhe shërbyese në fabrikën për përpunimin e qumështit dhe prodhimin e produkteve dhe nënprodukteve të tij duhet të bëhet kontrollimi i rregullt teknik i makinave ngarkuese dhe automjeteve transportuese që konsumojnë lëndë djegëse me qëllim që lirimi i gazrave nga automjetet e punës të jetë sa më i ultë. Me qëllim të zvogëlimit të ndotjes së ajrit e cila ndodhë si produkt i djegies së lëndëve djegëse të cilat nevojiten për prodhimin e avullit dhe nevoja të ngrohjes së hapësirave gjatë stinës së dimrit është e nevojshme të sigurohen kushtet për djegie sa më cilësore. Prandaj nëse përpjesëtimi i ajrit dhe lëndës djegëse është optimal atëherë në atmosferë lirohen gazrat me ndotës në sasi më të vogël. Në fabrikën për përpunimin e qumështit si dhe prodhimin e produkteve dhe nënprodukteve të tij si lëndë djegëse që nevojiten për prodhimin e avullit dhe ngrohjen e fabrikës gjatë stinës së dimrit, duke pasur parasysh kapacitetin prodhues dhe madhësinë e fabrikës do të përdoret sasi e vogël e mazutit, është ndërtuar oxhaku për përcjelljen e gazrave shkarkuese. Me qëllim të zvogëlimit gjegjësisht eliminimit të erërave – aromave të mundshme duhet bërë vendosja e ventilatorëve, me qëllim që të bëhet ventilimi i hapësirave prodhuese, prandaj në njërin anë të murit vendosen ventilatorët me biofiltër për pastrimin e ajrit, kurse në anën tjetër të murit vendosen hapjet për hyrjen e sasisë së ajrit të pastër/freskët aq sa është nxjerrur me anë të ventilatorëve, gjegjësisht duhet vendosur një sistem aspirimi i lidhur me aspiratorë që bëjnë qarkullimin e ajrit duke nxjerrë jashtë ajrin e ndotur dhe zëvendësuar atë me ajër të freskët.

Duhet të bëhet kontrollimi i rregullt i pajisjeve për trajtimin e ajrit dhe sistemit të ventilimit pjesët e dëmtuara të ndërrohen. Në hapësirat e fabrikës me qëllim të mbajtjes së temperaturave konstante (uljes së temperaturave) posaçërisht në hapësirat ku deponohet lënda e parë dhe produktet finale duhet bërë vendosja e ventilatorëve.

Objektet e fabrikës duhet të jenë me termoizolim në pajtim me kushtet klimatike dhe zonën klimatike, në mënyrë që gjatë stinës së dimrit të harxhohet sa më pak energji për ngrohje e gjatë stinës së verës të harxhohet sa më pak energji për ftohje.

Po ashtu, në rast të ndonjë dëmtimi eventual të gypave të kanalizimit apo gropës septike/implantit, duhet të izolohehen menjëherë dhe të riparohen në mënyrë që të eliminohet rrjedhja direkte në tokë dhe të bëhet evitimi i plotë i erërave që ndikojnë në ajër.

6.2. Masat për mbrojtjen e tokës

Për të parandaluar e zvogëluar ndikimet negative në tokë gjatë fazës së zhvillimit të aktiviteteve të projektit me infrastrukturën përcjellëse duhet ndërmarrë këto masa:

- ✓ Dyshemetë dhe muret e hapësirave prodhuese, të vendeve për deponimin e qumështit si lëndë e parë për prodhimin produkteve të qumështit, duhet të shtrohen me pllaka të qeramikës dhe në dysheme duhet të vendosen ujëmbledhësit,
- ✓ Duhet bërë betonimi dhe izolimi i sipërfaqeve të hapësirave ku është i vendosur rezervuari i mazutit, naftës dhe gazit, hapësirave të kaldajës, të gjeneratorit, hapësirave të parkingut të automjeteve me qëllim që të pengohet ndotja e tokës nga derdhja e vajrave dhe derivateve nga automjetet e parkuara në parkingun e fabrikës.
- ✓ Rezervuari për mazut është i prodhuar dhe i vendosur sipas standardeve të caktuara për rezervuar të lëndëve djegëse. Rezervuari i mazutit duhet të rrethohet me mur statik prej betoni.
- ✓ Stacioni i pompave për zbrazjen dhe mbushjen e rezervuarit për deponimin e mazutit duhet të jetë i vendosur në objekt të mbyllur, platoja e të cilit duhet të jetë e betonuar.
- ✓ Duhet të ndërtohet sistemi i pajisjeve kundër zjarrit me anë të ujit dhe të sigurohen aparatet me mjete kimike si dhe enët me rërë.
- ✓ Duhet të behet kontrollimi i rregullt teknik i makinave ngarkuese dhe transportuese që konsumojnë lëndë djegëse me qëllim që mos të ketë derdhje eventuale të derivateve dhe vajrave gjatë punës së tyre në tokë.
- ✓ Vaji i makinerive punuese e transportuese të ndërrohet në vende të caktuara dhe të izoluar për mos depërtimin e tyre në tokë,
- ✓ Vajrat duhet të deponohen në enë të posaçme, dhe pastaj t'u dorëzohen ndërmarrjeve të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura,
- ✓ Mbeturinat e ngurta komunale duhet të grumbullohen, klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë adekuat.
- ✓ Kontejnerët duhet të sigurohen për deponimin e të gjitha llojeve të mbeturinave të klasifikuara në bazë të rregullave dhe kushteve të përcaktuara me ligjin e mbeturinave.
- ✓ Pas mbushjes së kontejnerëve përmes ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponinë regjionale.

- ✓ Në rast të dëmtimit të sistemit të kanalizimit apo gropës septike të ujërave të zeza (impiantit) duhet të bëhet izolimi i plotë i tyre dhe problemet të rregullohen menjëherë.

6.3. Masat për mbrojtjen e ujit

Për të parandaluar e zvogëluar ndikimet negative në ujë gjatë operimit të projektit të qumështores të cilat janë cek të ‘ndikimet e mundshme në ujë’ duhet ndërmarrë këto masa:

- ✓ Duhet të bëhet pengimi i mundësisë për derdhjen e derivateve dhe vajrave nga makinat punuese e transportuese.
- ✓ Duhet të bëhet rregullimi i kolektorëve për grumbullimin e ujërave të ndotur të mundshëm nga larja e automjeteve, rrugëve përbrenda objektit, dhe përmes sistemit gypor të ndërtuar të dërgohen për trajtim në separatorin për pastrimin e ujërave (gropën septike apo impiantin për trajtim të ujit).
- ✓ Puseta trajtuese e ujërave (gropa septike apo impianti) duhet të ndërtohet në atë mënyrë që të parashihet mundësia për matjen e sasisë dhe marrjen e mostrave të ujërave.
- ✓ Ujërat e të reshurave atmosferike nga sipërfaqet punuese të grumbullohen dhe të përdoren mundësisht për ujitjen e sipërfaqeve të gjelbëruara.
- ✓ Duhet të pengohet larja e pajimeve vend e pavend, por në vende adekuate të paracaktuara për këtë qëllim.

Ujërat të përdorura nga larja e pajimeve për realizimin procesit të prodhimit si dhe nga larja hapësirave ku janë vendosura pajimet për realizimin procesit të prodhimit, ujërat të përdorura në kuzhinë dhe lavatriçe duhet të derdhen në impiantin për trajtimin biologjik të ujërave të ndotura me yndyra dhe vajra e detergjente të ndryshme, ujërat pas trajtimit biologjik në impiant të derdhën në recipient.

Parimi bazë i metodave biologjike të trajtimit të ujërave të ndotur bazohet në përdorimin e popullimeve biologjike të ndryshme, si të baktereve, mikroorganizmave dhe organizmave të tjerë, të cilat ushqehen me lëndët organike që ndodhen në ujërat e ndotur duke ulur në këtë mënyrë përmbajtjen e tyre në ujë. Metodatat biologjike mund të largojnë vetëm materialet organike të biodegradueshme, të cilat mund të përdoren si ushqim nga mikroorganizmat. Për këtë arsye qëllimi kryesor i përdorimit të trajtimit biologjik është kryesisht reduktimi i NBO-së. Metodatat biologjike për trajtimin e ujërave të ndotur gjejnë përdorim në disa nivele të trajtimit si në nivelin e parë (trajtimi primar), të dytë (trajtimi sekondar) dhe të tretë (trajtimi terciar) të trajtimit të ujërave, po ashtu përdoren për trajtimin e llumit të prodhuar nga impianti i trajtimit të ujërave të ndotur. Megjithatë përdorimi me i gjerë dhe i pazëvendësueshëm i tyre është ai në nivel sekondar trajtimi. Përdorimi më i pakët i tyre është ai në nivel primar trajtimi, ku e vetmja

metodë biologjike që përdoret për këtë qëllim janë pellgjet (rezervuarët) anaerobikë. Trajtimi biologjik (me lym aktiv) - skematikisht është i paraqitur më poshtë në figurën 26. Ky sistem për trajtimin e ujërave të ndotura zhvillohet në dy rezervuare. Këtu kemi të bëjmë me një trajtim klasik përmes lymit aktiv i cili krijohet në rezervuar gjatë procesit të ajrosjes së ujërave të ndotura në rezervuar. Ekzistojnë tri faza të procesit për trajtimin biologjik të ujërave të ndotura. Në fazën e parë kemi separatorin – i cili nënkupton ndarjen e materieve të ngurta dhe yndyrave, gjegjësisht largimin e tyre në formë mekanike nga ujërat e ndotura. Faza e dytë nënkupton akumulimin e ujërave të ndotura në rezervuar si në figurë, ku pastaj këto ujëra i nënshtrohen procesit të ajrosjes brenda në rezervuar me ç'rast vjen deri të procesi i zhvillimit të vrullshëm të baktereve të cilat edhe ashtu janë prezentë në ujërat e ndotura. Shkalla e lartë e prezencës së oksigjenit në rezervuar me ujëra të ndotura mundëson zhvillimin e vrullshëm të mikroganjve në ujëra duke e formuar lymin aktiv. Faza e tretë nënkupton kalimin e ujërave të turbullta me lym aktiv në rezervuarin e precipitimit (kullimit) ku lym aktiv precipitohet në fund të rezervuarit kurse uji i trajtuar nga pjesa e epërme e rezervuarit shkon në recipient përmes tubacionit përcjellës. Ndërsa një pjesë e lymit aktiv që konsiderohet si tepriçë largohet nga procesi dhe ajo është me koncentrim prej afërsisht 3% si materie e tharë, kurse pjesa tjetër kthehet prapë në procesin e ajrimit dhe i nënshtrohet procesit të zbërthimit biologjik të më tutjeshëm në rezervuar sipas fotos të paraqitur më poshtë.




Figura 26: Trajtimi biologjik (me lym aktiv)

Një cikël i trajtimit të ujërave me sistem biologjik zgjatë afërsisht 20 orë, prej të cilës 12 orë i takojnë procesit të përzierjes intensive dhe procesit të ajrosjes në rezervuar gjegjësisht procesit të zbërthimit biologjik të materieve organike që ndodhen në ujërat e zeza në rezervuar – faza e II-të, dhe 2-5 orë i përkasin procesit të precipitimit të ujit, 2 orë afërsisht janë të parapara për largimin e ujit të trajtuar nga rezervuari dhe pastaj nëpër tubacionin përcjellës deri në recipient,

kurse 20-30 minuta i takojnë largimit të lymit aktiv nga rezervuari i fundit. Si mes-produkt të këtij procesi gjegjësisht procesit të zbërthimit të materieve organike me oksigjen gjatë pastrimit të ujërave të ndotura kemi lirim të dyoksidit të karbonit.

Lymi pas procesit biologjik është stabil, nuk ka erë të pakëndshme dhe mund të përdoret për kompost. Ky është një sistem tipik aerob për trajtim biologjik të ujërave të ndotura nga industria e qumështit dhe këto sisteme zakonisht përdoren kur nuk kemi shkallë shumë të lartë të ndotjes në ujërave.

Ndërtimi i këtij sistemi duhet të bëhet me projekt të veçantë që nënkupton ndërtimin e rezervuarëve përkatës prej betoni dhe montimin e pajisjeve adekuate për realizimin e procesit. Me këto sisteme të pastrimit të ujërave të ndotura arrihet një shkallë e lartë e pastrimit dhe nëse sistemet janë të mirëmbajtura mirë atëherë niveli i parametrave të ujërave të trajtuar para lëshimit në rrjet të kanalizimit nuk do të jenë më të larta se vlerat e caktuara sipas legjislacionit në fuqi për ujëra.

Kompania që operon me këtë projekt (DRENA sh.p.k.) duhet të bëjë matjen e cilësisë së ujit të shkarkuar (ujërave atmosferik e ujërave të zeza), vlerat e fituara do të krahasohen me vlerat standarde të lejuara dhe nuk guxojnë të jenë më të larta se vlerat e caktuara sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor.

6.4. Masat për mbrojtjen e florës dhe faunës

Sipas analizave të bëra deri tani në lidhje me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës mund të vie deri të ndikimet në florë dhe faunë. Mirëpo sipas gjendjes faktike në terren respektivisht në lokacionin e caktuar nuk kemi zhdukje të vegjetacionit përpos nga sipërfaqet manipulative, nga sipërfaqja nën objektet e fabrikës për përpunimin dhe prodhimin e produkteve të qumështit kjo do të thotë se kemi të bëjmë me koncentracion të vogël të ndotësve. E njëjta vlen edhe për faunën që do të thotë se nuk pritet të ketë ndikime negative, në këtë lokacion nuk ekziston (zhvillohet) fauna për arsye se janë të ndërtuara objektet afariste dhe industriale dhe fauna është larguar nga ky lokacion dhe zhvillohet në lokacionin jashtë territorit të zonës industriale. Kompania nuk duhet të deponoj pa kontroll mbeturina në vende jashtë hapësirave të dedikuara për fabrikën për përpunimin e qumështit dhe prodhimin e produkteve të qumështit por ato duhen të deponohen në vende me destinacion të caktuar.

Në raste të lajmërimit të zjarrit menjëherë të merren masa për neutralizimin e tij në mënyrë që të mos dëmtohet bota bimore. Pajisjet kundër zjarrit duhen të ruhen në mënyrë të veçantë.

Për mbrojtjen e botës shtazore (edhe pse nuk ekziston në këtë lokacion) kompania duhet të tregoj kujdes duke kufizuar lëvizjet e të punësuarve jashtë zonës të fabrikës për përpunimin e qumështit dhe prodhimin e produkteve të qumështit dhe të kenë kujdes në nivelin e zhurmës, cilësinë e ajrit, ujit, etj.

6.5. Masat për mbrojtjen nga zhurma

Gjatë funksionimit të fabrikës për përpunimin e qumështit si dhe për prodhimin e produkteve të qumështit, pronari i fabrikës duhet të bën matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtjen nga zhurma. Matjet duhet bërë në afërsi të fabrikës dhe të objekteve të banimit. Për vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet të krahasohen me vlerat e lejuara me standarde për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit.

Në raste se zhurma e mesit nga matjet tejkalon atë të lejuarën atëherë duhet të merren të gjitha masat që niveli i zhurmës të jetë në nivelin e lejuar sipas rregullave në fuqi. Në varshmëri nga fazat e procesit të punës duhet edhe të punësuarit në ato vende të punës të përdorin mjetet kundër zhurmës.

Meqë, kryesisht i tërë aktiviteti i qumështores Drena zhvillohet brenda objektit të fabrikës (hapësirë apo objekt i mbyllur) nuk pritet që zhurma të jetë faktor i rëndësishëm që krijon ndonjë problematikë të theksuar për zonën përreth (meqë kjo zonë veç është e destinuar për këtë qëllim – zonë për industri të lehta).

6.6. Masat për mbrojtjen nga rreziqet aksidentale

Për të parandaluar dhe zvogëluar rreziqet e mundshme janë marrë dhe duhet ndërmarr masat si në vijim:

Të merren të gjitha masat për evitimin e derdhjes së derivateve të naftës dhe vajit nga makinat transportuese dhe të udhëtarëve.

Të merren të gjitha masat për evitimin e derdhjes mazutit dhe naftës nga rezervarët, dhe eventualisht gazit. Rezervuarët për mazut dhe naftë janë prodhuar sipas standardeve të caktuara dhe të vendosur po ashtu sipas standardeve.

Në rezervuarin e mazutit i cili është i vendosur mbi tokë duhet të vendoset sistemi për sjelljen e ujit për ftohje të rezervuarit në kohë me temperatura të larta. Rezervuari i mazutit duhet të rrethohet me mur statik prej betoni, largësia e murit nga rezervuari dhe lartësia e murit duhet ndërtuar në mënyrë që ta zënë tërë sasinë e mazutit. Është obligim permanent i punëtorëve që të kontrollojnë sistemin e gypave me mekanizëm për mbushje të rezervuarit dhe zbrazje të mazutit nga rezervuari gjer në kaldajë. Është obligim që rezervuari i mazutit të kontrollohet

brenda 5 viteve të para të punës për të përcjell dëmtimet e trashësisë së mureve nga veprimi korroziv, pas 5 viteve kontrolli duhet bërë për çdo dy vite.

Evitimin nga derdhja e amoniakut (freonit) nga komora ftohëse, freonin nga komora ftohëse duhet të e ndërrojnë vetëm kompanitë e licencuara për trajtimin e mbeturinave të rrezikshme. Duhet të ndërtohet sistemi i pajisjeve kundër zjarrit me anë të ujit dhe të sigurohen aparatet me mjete kimike si dhe enët me rërë.

Në korridoret dhe hapësirat tjera të fabrikës duhet të instalohen hidrantët me pajimet përcjellëse dhe S aparatet plotësuese. Zakonisht vendosen nga dy aparate mobile zjarrfikëse të tipit (S9) dhe një arkë me rërë.

Të merren të gjitha masat e sigurisë konform ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mjedisit të punës.

Të hartohet rregullorja ku do të definohen procedurat për rastet aksidentale, të bëhet aftësimi i të punësuarve dhe të caktohen obligimet e tyre në situata aksidentale.

6.7. Masat rehabilituese pas përfundimit të projektit

Pas përfundimit të aktivitetit prodhues në fabrikën për përpunimin e qumështi si dhe prodhimin e produkteve dhe nënprodukteve të tij, e kjo varet nga vjetërsia e pajimeve të fabrikës, pastaj varet se a do të vazhdohet aktiviteti edhe për një kohë të gjatë në të ardhmen ku nevojitet blerja e pajimeve të reja apo do të ndërpritet aktiviteti prodhues. Objektet e fabrikës do të mund të përdoren për ndonjë biznes/aktivitet tjetër pasi që ekzistojnë në zonë industriale të lehtë, por në rastë se kërkohet nevoja për rrënimin e objektit të fabrikës atëherë bazamentet si dhe platot nga betoni të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponi adekuate të destinuara për këtë qëllim. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga realizimi i projektit. Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga qëllimi i rikultivimit i cili nënkupton që pas përfundimit të punëve në procesin teknologjik të qumështores Drena, sipërfaqeve të degraduara prapë të iu kthehet funksioni i saj primar (prodhimi i biomasës), dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem.

7. PROGRAMI I MONITORIMIT

Investitori/kompania është i obliguar që të bëjë monitorimin e përhershëm të ndikimeve të mundshme negative në mjedis, e posaçërisht monitorimin e ujërave shkarkuese të cilat derdhen nga projekti (fabrika për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij) por paraprakisht ato ujëra duhet të trajtohen para se të shkrkohen në recipient. Monitorimi i ujit duhet të bëhet me marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave në institute adekuate, për të vërtetuar nivelin e pastërtisë së ujërave që shkarkohen.

Të bëhet kontrollimi i rrjetit të kanalizimit, i gropës septike dhe impiantit për trajtim të ujit. Kontejnerët e mbeturinave të zbrazen rregullisht përmes anagzimit të kompanive të licencuara. Të respektohen të gjitha rregullat teknike dhe kërkesat lidhur me sigurinë ndaj zjarrit, sigurinë në punë dhe mbrojtjen e mjedisit.

8. PËRFUNDIME

Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis për projektin e ‘fabrikës për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij’ në Klinë të Poshtme të komunës së Skënderajt, në të cilën kryhen kryesisht aktivitetet për grumbullimin e qumështit, e mandej përpunimin e tij dhe prodhimin e produkteve e nënprodukteve të qumështit për konsum të gjerë, është bërë si rezultat i punës në terren, konsultimeve me investitorin dhe konsultimin e literaturës profesionale, që për momentin vlerësohet se ofron të dhëna për vlerësimin e gjendjes mjedisore dhe rekomandimin për një mjedis të shëndosh.

Projekti nuk shoqërohet me shpërngulje të popullatës pasi që zona ku shtrihet projekti veç është e destinuar për këso lloj qëllimesh afaristo-biznesore e industri të lehtë, pasi që nuk ndikon negativisht në shëndetin e njeriut, ngase ndikimi në mjedis nga procesi i punës së projektit është pothuajse minimal meqë kryesisht procesi zhvillohet përbrenda objektit, por përkundrazi do të ndikoj pozitivisht në aspektin e drejtpërdrejt të punësimit të një numri të caktuar të punonjësve dhe tërthorazi edhe për arsye të bashkëpunimit me fermerët e zonës për grumbullimin e qumështit nga ta.

Andaj, pas punimit të këtij raporti të VNM-së, mund të konkludohet se fabrika për përpunimin e qumështit si dhe prodhimin e produkteve e nënprodukteve të qumështit, nuk ka potencial të rrezikimit të shëndetit të njerëzve, gjithashtu ndikimet në tokë, ujë, ajër dhe peizazh, pas identifikimit dhe zbatimit të të gjitha masave mbrojtëse të rekomanduara në këtë raport të VNM-së, konstatojmë se ato mund të zvogëlohen në nivel të lakmueshëm. Fabrika për

përpunimin e qumështit si dhe prodhimin e produkteve e nënprodukteve të qumështit rregullisht kontrollohet për sistemin ndërkombëtarisht të njohur HACCP në prodhimin e gjërave ushqimore. HACCP-i është sistem i cili i identifikon rreziqet specifike dhe masat për kontrollimin e tyre për të siguruar sigurinë e cilësisë së produkteve të qumështit. Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme dhe i mundësojnë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) dhënien e mendimit pozitiv për ‘Pëlqim Mjedisor’ për fabrikën për përpunimin e qumështit si dhe prodhimin e produkteve dhe nënprodukteve të tij, e cila shtrihet në zonën industriale në Klinë të Poshtme të komunës së Skënderajt, sipas kërkesës së kompanisë DRENA sh.p.k.

9. PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

Përshkrimi i projektit

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë themelore për hartimin e raportit të VNM-së. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë terren ku do të shtrihet projekti.

Projekti ‘Fabrikën Drena për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të qumështit’ nga “DRENA sh.p.k.” shtrihet në ZK Klinë e Poshtme të komunës së Skënderajit, saktësisht në parcelën me nr. P-72015025-01111-0, me sipërfaqe 8557 m². Distanca e lokacionit ku shtrihet fabrika për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij të qumështores Drena deri në qendër të fshatit Klinë e Poshtme është afërsisht 600 m, ndërsa distanca deri në qendrën e qytetit të Skënderajit është rreth 850 m)

Gjendja ekzistuese e terrenit dhe infrastruktura

Lloji i shfrytëzimit i parcelës me nr. P-72015025-01111-0 është Bujqësore (Arë e klasës 1) me 3239 m² dhe Tokë ndërtimore (oborr) me 5318 m², ndërsa sipas HZK-së të Skënderajit bën pjesë në ZI-L (zonë industriale e lehtë). Lloji i pronave është shoqërore (urbane) të cilat kompania ‘DRENA shpk’ i ka marrë me qirambajtje për 99 vite.

Lokacioni ku shtrihet fabrika dhe qumështorja Drena ka kyçe të drejtpërdrejt në rrugën kryesore Skënderaj – Klinë e Poshtme, dhe qasja në rrugë është e lehtë dhe e përshtatshme për hyrje-dalje. Po ashtu, përreth fabrikës dhe objektit të qumështores ka objekte tjera afariste dhe prodhuese. Në anën e majtë ndodhet një mulli elektrik (kompani private), në pjesën e poshtme dhe përreth parcelës kalon dega e lumit Klina e cila pastaj shkarkohet në lumin kryesor. Në një distancë më të largët gjithashtu ka objekte tjera afariste prodhuese dhe shtëpi banimi, edhe pse ky projekt nuk i atakon drejtpërdrejt shtëpitë e banimit pasi që aktiviteti zhvillohet kryesisht brenda objekteve, dhe komponenta më e atakuar është uji sipërfaqësor dhe nëntokësor. Në përgjithësi, vendi i projektit është rregulluar dhe projektuar nga investitori për një funksionalizim sa më të përshtatshëm dhe me infrastrukturë të nevojshme (ujë, rrymë, rrugë).

Përshkrimi teknik i projektit

Qumështorja Drena është e pajisur me teknologjinë më moderne, dhe duke qenë e pajisur me makineri moderne, i respekton në përpikëri edhe standardet e rregullativës ushqimore HACCP dhe ISO. Drena përpunon qumështin dhe prodhon një sërë produktesh e nënproduktesh për konsum të gjerë. Prodhimi i produkteve në qumështoren Drena është i ndarë në sektore të ndryshme që përfshin disa sektorë, si:

Sektorët e prodhimit në Qumështoren Drena përfshijnë sektorin e përpunimit të qumështit UHT – i pajisur me pasterizatorë dhe homogjenizatorë modernë, me një kapacitet prodhimi prej 6,000 litra në orë.

Spektori i mbushjes në shishe – linjë automatike me kapacitet deri në 8,000 litra në orë, që garanton sterilitet dhe ruajtje optimale të freskisë.

Spektori i kremit dhe ajkës me specë – teknologji moderne për ndarje dhe përpunim të yndyrës së qumështit, duke ruajtur shijen autentike tradicionale.

Spektori i kosit – përpunim i fermentuar me kultura bakteriale të kontrolluara, që siguron një kos me strukturë ideale dhe të pasur në vlera ushqyese.

Spektori i djathit – përfshin linja të posaçme për prodhimin e djathërave të freskët, ku përfshihen edhe metoda tradicionale të përpunimit.

Spektori i produkteve të freskëta – përgatitje e produkteve të ndryshme të bazuara në qumësht, të gatshme për konsum të menjëhershëm.

Për të gjitha produktet e Drenës ekzistojnë skemat teknologjike dhe hapat që ndiqen për zhvillimin e proceseve teknologjike gjatë përfitimit të produkteve të Drenës (që janë të paraqitura detajisht në këtë raport të VNM-së).

Me një infrastrukturë teknologjike bashkëkohore dhe një ekip të përkushtuar, qumështorja Drena vazhdon të jetë sinonim i cilësisë, traditës dhe inovacionit në industrinë ushqimore të vendit.

Alternativat e mundshme të projektit

Meqë projekti (qumështorja Drena) ka qenë në operim në kohën kur është përgatitur vlerësimi i ndikimit në mjedis alternativat tjera për lokacione të mundshme nuk kanë qenë opsion që të analizohen. Por duke marrë parasysh lokacionin aktual ku shtrihet projekti në ZK Klinë të Poshtme, të Skënderajt, i cili gjendet në rrugën magjistrale Skënderaj – Klinë e Poshtme, ky lokacion vlerësohet me përparësi të madhe. Përparësitë e këtij lokacioni janë: qasja e menjëhershme në rrugën magjistrale, lehtë dhe e frekuentuar nga shumë makina në lëvizje, zona është tipike biznesore (sipas HZK të komunës së Skënderajt është zonë industriale e lehtë – ZIL), dhe ka edhe objekte tjera afariste e biznesore si dhe industriale në këtë lokacion.

Përshkrimi i ndikimeve të mundshme në mjedis

Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis është bërë vetëm për fazën e zhvillimit të punës së projektit, meqë kur është bërë ky raport i VNM-së qumështorja ka qenë në operim.

Ndikimet në ajër: Ndotja e ajrit ndodh nga:

- Gazrat që lirohen gjatë djegies së mazutit, gazit apo naftës, por ndotja është minimale.
- Aroma e pakëndshme që del nga proceset teknologjike për përpunimin e qumështit.
- Emisionet nga gjeneratori dhe automjetet transportuese, duke përfshirë automjetet për lëndën e parë dhe produkte të përpunuara.
- Komponentët ndotës (CO, NO_x, HxCy, SO₂, Pb), me ndikim të varur nga kushtet meteorologjike dhe trafiku.
- Aromat e rrjetit të kanalizimit dhe ujërave të zeza në rast dëmtimi.

Ndikimet në tokë: Ndotja e tokës mund të ndodh për shkak të:

- Mbeturinave të lëngëta me yndyra gjatë pastrimit të pajisjeve dhe hapësirave prodhuese.
- Derdhjes së karburanteve (mazut, gaz, naftë) gjatë proceseve teknologjike.
- Rënies së vajrave dhe derivateve nga automjetet transportuese dhe të parkuara.
- Pluhurave, mbeturinave organike e jo-organike, dhe materiale ambalazhuese.

Ndikimet në ujë: Ndotja e ujërave mund të shkaktohet nga:

- Mbeturinave të lëngëta me yndyra gjatë larjes dhe dezinfektimit të pajisjeve teknologjike.
- Derdhja e mazutit dhe naftës nga rezervuarët dhe makineritë operative.
- Lirimi i vajrave nga automjetet transportuese dhe të parkuara.
- Rënia e ujërave të ndotura nga gypat e kanalizimit dhe gropat septike në rast defektesh.

Ndikimet nga zhurma: Ndikimi nga zhurma mund të shkaktohet nga

- Zhurma kryesisht vjen nga proceset teknologjike brenda fabrikës dhe nga automjetet transportuese për lëndën e parë dhe produktet e përpunuara.
- Për shkak të teknologjisë së pajimeve të vendosura brenda dhe numrit të vogël të automjeteve, zhurma është minimale dhe nuk ka ndikim negativ të theksuar në mjedis.

Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore: Ndotja e ujërave mund të shkaktohet nga

- Aksidentet mjedisore të mëdha: Nuk priten të ndodhin për shkak të natyrës së veprimtarisë prodhuese.
- Shkaktarët e aksidenteve: Mund të përfshijnë zjarret, derdhjet e mazutit, naftës, lubrifikantëve dhe shpërthimet e rezervuarëve.
- Rreziqet nga zjarri: Rrezikohet jeta dhe shëndeti i njeriut si dhe mjedisi, megjithatë projektet preventive për mbrojtje nga zjarri janë të implementuara.
- Metodologjia e vlerësimit të rrezikshmërisë: Përfshin identifikimin e rrezikut, analizën e pasojave, dhe vlerësimin e rrezikut bazuar në rregullore.

Masat për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme në mjedis

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve të mundshme negative në mjedis dhe atë në ajër, tokë, ujë, në ruajtjen e peizazhit, si dhe në ruajtjen e shëndetit të njeriut, gjatë fazës së operimit të projektit të qumështores Drena me infrastrukturën përcjellëse të nevojshme, duhet të merren masat që janë përshkruar në këtë raport të VNM-së. Si përmbledhje masash, si në vijim:

Masat për mbrojtjen e ajrit

- Kontrollimi teknik i automjeteve transportuese për zvogëlimin e emetimeve të gazrave.
- Sigurimi i djegies cilësore të karburanteve me përpjesëtim optimal të ajrit dhe mazutit.
- Vendosja e ventilatorëve me biofiltër për pastrimin dhe qarkullimin e ajrit.
- Termoizolimi i ndërtesave për të minimizuar shpenzimin e energjisë në dimër dhe verë.
- Riparimi i dëmtimeve në sistemin e kanalizimit për të parandaluar ndotjen e ajrit.

Masat për mbrojtjen e tokës

- Përdorimi i dyshemeve dhe mureve të qeramikës në hapësirat prodhuese.
- Betonimi dhe izolimi i rezervuarëve dhe hapësirave për automjete për të parandaluar ndotjen nga vajrat.
- Sigurimi i rezervuarëve të mazutit me mur statik betoni.
- Menaxhimi i mbeturinave sipas rregullave dhe dorëzimi i vajrave të përdorur ndërmarrjeve të licencuara.
- Kontrolli teknik i rregullt i makinerive për të parandaluar derdhjet e vajrave.

Masat për mbrojtjen e ujit

- Rregullimi i kolektorëve për trajtimin e ujërave të ndotura.
- Grumbullimi i ujërave të reshjeve për ujitjen e hapësirave të gjelbëruara.
- Larja e pajimeve vetëm në vende të paracaktuara.
- Përdorimi i impianteve biologjike për trajtimin e ujërave të ndotura, duke siguruar që ujërat e trajtuara të derdhen në recipientë.

Masat për mbrojtjen nga rreziqet aksidentale

- Evitimi i derdhjeve: Implementimi i masave për të shmangur derdhjet e naftës, vajit, mazutit, dhe gazit nga automjetet transportuese dhe rezervuarët.
- Rezervuarë sipas standardeve: Rezervuarët e mazutit duhet të jenë të prodhuar dhe të instaluar sipas standardeve, të pajisur me sistem ftohjeje dhe të rrethuar me mur betonit për mbrojtje të shtuar.
- Kontroll i rregullt: Kryerja e kontrolleve periodike për sistemet e gypave dhe rezervuarët për të shmangur dëmtimet korrozive.
- Siguri kundër zjarrit: Instalimi i pajisjeve kundër zjarrit, duke përfshirë hidrante, aparate zjarrfikëse mobile, dhe enë me rërë.
- Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme: Freoni nga komora ftohëse duhet trajtuar nga kompani të licencuara.
- Masat e sigurisë: Zbatimi i ligjit për siguri në punë, aftësimi i punëtorëve për rastet aksidentale dhe hartimi i rregullores për procedura në situata emergjente.

Masat rehabilituese pas përfundimit të projektit

- Rikultivimi i hapësirave: Sipërfaqet e dëmtuara do të revitalizohen për të rikthyer funksionin primar të prodhimit të biomasës dhe zvogëluar ndikimet negative në ekosistem.

- Përdorimi i objekteve: Objektet e fabrikës mund të shfrytëzohen për aktivitete të tjera biznesi në zonën industriale.
- Rrënimi i strukturave: Në rast nevojë për rrënimin e objektit të fabrikës, materialet do të deponohen në destinacione të përshtatshme.

Kosto investive e projektit

Investitori/Kompania:	DRENA SH.P.K.
Adresa:	Rruga Sala e Hamit Jashari, p.n.
Komuna	Skënderaj
Kontakti:	rrustemrukolli@hotmail.com rrustemrukolli@icloud.com
Kosto e përgjithshme e investimeve:	920 000.00 €

Lista e bibliografisë të burimeve të përdorura:

- Projekti i ndërtimit të fabrikës për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij nga “Drena sh.p.k.” në Klinë të Poshtme të Skenderajt,
- Përshkrimi teknik i procesit të punës dhe plani i organizimi i kompanisë DRENA sh.p.k.,
- Legjislacioni i përmendur në kapitullin 2, gjegjësisht 2.1 – Rregullativa ligjore.
- Plan i zhvillimit të Skenderajt 2017 – 2025.
- Të dhëna nga ueb faqja e komunës së Skenderajt: <https://skenderaj.rks-gov.net/>
- Literaturë tjetër profesionale e konsultuar.

Shtojcat:

1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë Drena sh.p.k.;
2. Kopjen e planit;
3. Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme (qirambajtje për 99 vite);
4. Vendimi mbi LMK për ndërtimin e objektit për zgjerimin e kapaciteteve prodhuese të qumështores (depo) me etazhitet P+2 në parcelën kadastrale me nr. P-72015025-01111-0 (vendimi i datës 17.10.2023), dhe
5. Vendimi mbi LMK për ndërtimin e katit shtesë S+P+2 në objektin ekzistues afarist S+P+1E në të njëjtën parcelë (vendimi i datës 27.09.2024);
6. Licenca për VNM të personit fizik të licencuar për hartimin e raportit të VNM-së;
7. Plan i rievimit të terrenit nga gjeodeti i licencuar;
8. Kopja elektronike e raportit të VNM-së – në CD